Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/09
Datë: 02.11.2026

Në mbështetje të nenit 92, paragrafi 4, dhe të nenit 93, paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 78 të Rregullores Nr. 17/2024 të Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 2 nëntor 2026, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept-dokumenti për Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës.

2. Obligohen Zyra për Qeverisje të Mirë, në kuadër të Zyrës së Kryeministrit, dhe institucionet e tjera kompetente për zbatimin e këtij Vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.

3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI
Albin Kurti
Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave;
- Të gjithë ministrave;
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së;
- Arkivit të Qeverisë.

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government
Zyra e Kryeministrit-Ured Premijera-Office of the Prime Minister
Zyra për Qeverisje të Mirë/Kancelarija za Dobro Upravljanje/Office on Good Governance

Draft Koncept dokument për Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës

Përgatitur nga: Zyra për Qeverisje të Mirë-Zyra e Kryeministrit

16.10.2026

Përmbajtja

Shkurtesat 3
Përmbledhje e koncept dokumentit 4
Hyrje 6
Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit 7
Kapitulli 2: Objektivat 28
Kapitulli 3: Opsionet 30
Kapitulli 3.1: Opsioni 1 ose opsioni pa asnjë ndryshim 31
Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit 31
Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë hartimi i Ligjit për Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës 32
Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme 34
Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave 40
Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi 41
Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve 42
Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme 45
Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet 52
Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm 54
Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin 54
Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik 57
Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore 60
Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore 64
Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore 67

Shkurtesat

ZKM-Zyra e Kryeministrit

ZQM-Zyra për Qeverisje të Mirë

BE-Bashkimi Evropian

GJSHK-Gjuha e Shenjave në Kosovë

GjSh-Gjuha e Shenjave

KNPAK-Konventa Ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara

MASHTI-Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit

SHKSH-Shoqata Kosovare e të Shurdhërve

Përmbledhje e koncept dokumentit

Koncept dokumenti për gjuhën e shenjave ka për qëllim paraqitjen e një opsioni të pranueshëm për zgjidhjen e problemit të gjuhës së shenjave për personat e shurdhër në Republikën e Kosovës, me synimin që të drejtat e personave të shurdhër të avancohen në shoqërinë kosovare si dhe të pamundësohet diskriminimi dhe izolimi i tyre.

Problem kryesor i koncept dokumentit për gjuhën e shenjave paraqitet mungesa e një infrastrukture ligjore të qëndrueshme për gjuhën e shenjave në Kosovë, e cila i ekspozon personat e shurdhër, në probleme të një efekti domino, që qojnë deri në izolimin e tyre, problemet e qasjes në arsim dhe edukim, problemet në qasje në shërbime si dhe mbi të gjitha diskriminimin e tyre.

Opsioni i propozuar është hartimin i një ligji për gjuhën e shenjave në Kosovë, i cili do të arrinte rezultate konkrete, do të përmirësonte situatën ligjore, sigurinë juridike si dhe do të rregullonte statusin e personave të shurdhër në Kosovë dhe do të forconte mekanizmat institucional për çështjen e të shurdhërve si dhe gjuhës së shenjave. Opsioni i propozuar (opsioni 3), krahas opsioneve të tjera 1 dhe 2 është opsion i cili synon që të gjejë një zgjidhje më të qëndrueshme, respektivisht të krijojë një bazë më të fortë ligjore, e cila do t'i ndihmonte personave të shurdhër, për tu integruar në shoqëri, për të pasur qasje në arsim dhe shëndetësi si dhe për të pasur qasje efektive, në të gjitha fushat e jetës.

Informacionet e përgjithshme	
Titulli	Koncept Dokumenti për Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës
Ministria bartëse	Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit- Republika e Kosovës.
Personi kontaktues	Habit Hajredni-Drejtor +383 38 200 140 70
PKZH	Planit Kombëtar për Zhvillim 2025-2027
Prioriteti strategjik	Rritja e cilësisë ne zhvillimin e politikave dhe ofrimin shërbimeve për qytetaret dhe bizneset
Masa Strategjike:	Forcimi I kapaciteteve institucionale për parandalimin e diskriminimit
Aktiviteti:	Hartimi i Koncept Dokumentit për Gjuhën e Shenjave

Vendimi i Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM, nr ref 021/2024, datë 21.02.2024	
Çështja kryesore	Çështja kryesore ka të bëjë me mungesën e një ligji për gjuhën e shenjave, i cili në shumicën e rasteve i ka vendosur në pozitë jo të favorshme personat e shurdhër. Me qëllim të adresimit të këtij problemi është rekomanduar hartimi i një Ligji për Gjuhën e Shenjave, i cili do të adresonte shumicën e çështjeve që kanë të bëjnë me rregullimin e statusit të personave të shurdhër dhe mënyrën e komunikimit të tyre përmes gjuhës së shenjave.
Përmbledhje e konsultimeve	Ka pasur konsultime me akterët dhe institucionet të cilat janë të përfshira në zbatimin e opsionit të zgjedhur. Konsultime të rëndësishme janë zhvilluar me Shoqatën Kosovare të Shurdhërve, në takimet e mbajtura. Po ashtu, pjesë e konsultimeve janë edhe takimet e tjera me institucionet relevante, të realizuara nga grupi punues.
	1. Takimet për hartimin e koncept dokumentit; 2. Takimet e grupit punues;

	3. Takimet me institucionet e përfshira në kuadër të zbatimit të opisionit të zgjedhur; 4. Konsultimet paraprake; 5. Konsultimet publike.
Opsioni i propozuar	Hartimi i Ligjit për Gjuhën e Shenjave-Opsioni i tretë

Ndikimet kryesore të pritshme	
Ndikimet buxhetore	Opsioni i propozuar mbulohet nga planifikimet aktuale buxhetore dhe se planifikimi i buxhetit i cili do të bëhet në kuadër të planifikimeve, sipas hapave të zbatimit të opsionit përkatës të propozuar me këtë koncept dokument Nje ligj i mundeshem i Gjuhes se shenjave mendohet që np vitet ne vijim 2026 dhe 2027 te ketë kosto shtesë e parapare rreth 150000 (njëqind e pesëdhjetë mijë euro) në vitin 2026 50000 euro si dhe ne vitin2027 100,000 e që i bie diku 150000 (njëqind e pesedhjete mijë) në ndërsa e gjithë kostoja opsionit te rekomanduar nr 3, parashihet te jetë 269.400.00 euro përfshire kategoritë e shpenzimit paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime si dhe mjetet ekzistuese.
Ndikimet ekonomike	Ligji për gjuhën e shenjave do të promovojë përfshirjen e mëtejshme të personave të shurdhër në tregun e punës, duke ofruar më shumë mundësi për punësim dhe avancim në karrierë. Kjo gjithashtu mund të krijojë treg për shërbime interpretimi të gjuhës së shenjave, duke sjellë investime të reja në këtë fushë. Mundësitë për punësim, duke pasur të rregulluar edhe aspektin ligjor të gjuhës së shenjave do të rezultojnë edhe me një mirëqenie ekonomike të personave të shurdhër. LIGJI Nr. 03/L-019 PËR AFTËSIMIN, RIAFTËSIMIN PROFESIONAL DHE PUNËSIMIN E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA në nenin 12.2 përcakton se "***Çdo punëdhënës është i obliguar të punësoj një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtor***". Andaj, mbi bazën e përcaktimeve ligjore, opsioni i zgjedhur dhe miratimi i një ligji të ri për gjuhën e shenjave do të mundësojmë forcimin e mekanizmave dhe mundësinë që personat e shurdhër të punësohen më lehtëissht.
Ndikimet shoqërore	Ligji për gjuhën e shenjave do të promovojë përfshirjen dhe respektimin e komunitetit të shurdhër në shoqëri, duke krijuar një mjedis më të përshtatshëm për ta për të jetuar dhe punuar. Në aspektin e vlerësimit të ndikimeve shoqërore, e rëndësishme është të theksohet që ligji për gjuhën e shenjave do të mundësojë që personat e shurdhër të mos kenë diskriminimin në jetën e tyre, si në punë ashtu edhe në aspektet e tjera
Ndikimet mjedisore	Nuk ka ndikime direkte, mirëpo me përmirësimin e qasjes në informacion do të ndikojë në kujdesin e shtuar mjedisor nga ana e komunitetit të shurdhërve. Përmasimi i qasjes në informacion do të ketë ndikime indirekt edhe në marrjen e informacioneve të duhura për aspektin mjedisor.
Ndikimet ndër-sektoriale	Koncept dokumenti nuk pritet të ketë ndonjë ndikim ndërsektorial.
Ngarkesat administrative për kompanitë	Përmirësimi i qasjes dhe shërbimeve për personat e shurdhër mund të zvogëlojë ngarkesën administrative për ta dhe për familjet e tyre, duke e bërë jetën e tyre të përditshme më të lehtë. Krijimi i një mekanizmi për interprëtët dhe shërbimet e interpretëve gjuhësor do ti mundësojë personave të shurdhër që të lehtësojnë qasjen e tyre në shërbime administrative publike në përgjithësi.

Testi i NVM-ve	Nuk aplikohet

Hapat e ardhshëm	
Afatshkurtër	1. Finalizimi i koncept dokument; 2. Konsultimet publike lidhur me koncept dokumentin; 3. Miratimi i koncept dokumentit;
Afatmesëm	1. Themelimi i grupit punues për Ligjin për Gjuhën e Shenjave; 2. Hartimi i Ligjit për Gjuhën e Shenjave; 3. Konsultimet Publike për Ligjin për Gjuhën e Shenjave; 4. Mbrami në Qeveri dhe në Kuvend i Ligjit për Gjuhën e Shenjave 5. Zbatimi i ligjit dhe krijimi i mekanizmave të ri në kuadër të ligjit 6. Ndalimi i rasteve të diskriminimit për personat e shurdhër 7. Krijimi i mundësive të reja teknlogjike dhe ofrimit të shërbimeve për të shurdhërit në kohë reale.

Hyrje

Koncept dokumenti për gjuhën e shenjave synon që të rregullojë dhe të adresojë zgjidhjen e problemeve për gjuhën e shenjave në Kosovë. Nga ajo çfarë është arritur deri tani, Republika e Kosovës nuk ka një infrastrukturë të fortë ligjore në ofrimin e gjuhës së shenjave. Kjo i bën shumë shpesh personat e shurdhër që të ndjehen të diskriminuar, për shkak të mos ofrimit të gjuhës së shenjave. Në kontekstin e kësaj, ofrimi i një ligji që rregullon gjuhën e shenjave do të kompletonte infrastrukturën ligjore, do të ofronte siguri juridike për të personat e shurdhër, do të krijonte mekanizma më efikas për ofrimin e gjuhës së shenjave, do të parandalonte diskriminimin dhe do ti bënte të ndjehen të barabartë personat e shurdhër, mekanizma shtetëror për ofrimin e gjuhës së shenjave, do të ishin të të fortë dhe të sigurtë në ofrimin e veprimtarisë së tyre, do të rritej siguria juridike dhe do të përmirësohej niveli i zbatimit të të drejtave të njeriut.

Ky koncept dokument ka ndjekur strukturën e standardeve dhe doracakut për hartimin e koncept dokumentit, duke propozuar një opsion të avancuar, që zgjidh problemin kryesor. Koncept dokumenti definon problemin, bazuar në të dhëna konkrete, si rezultat i konsultimeve me SHKSH dhe institucionet e tjera relevante. Po ashtu, konceptim paraqet të dhëna reale që definojnë problemin kryesor dhe përkufizojnë atë. Koncept dokumenti bazohet në paraqitjen e një perspektive krahasimore, ku merren për bazë praktikat e shteteve të avancuara, të cilat kanë miratuar Ligjin për Gjuhën e Shenjave. Po ashtu, koncept dokumenti arsyeton edhe opsionin e propozuar.

Figura 1: Tabela me informacione të përgjithshme për koncept dokumentin

Titulli	Koncept Dokumenti për Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës
Ministria bartëse	Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejtat e Njeriut, Mundësitë e Barabarta dhe Jo-Diskriminim/Zyra e Kryeministrit- Republika e Kosovës
Personi kontaktues	Habit Hajredni-Drejtor +383 38 200 140 70
PKZH	Planit Kombëtar për Zhvillim 2025-2027
Prioriteti strategjik	Përmirësimi i cilësisë në shërbime sociale për persona me aftësi të kufizua

Objektivi specifik	Përmirësimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse sociale për personat me aftësi të kufizua
Aktiviteti	Hartimi i koncept dokumentit të Ligjit për shërbimet në gjuhën e shenjave
Grupi punues	Habit Hajredini-Zyra për Qeverisje të Mirë-Kryesues; Mentor Borovci-ZKM; Enver Kurtalani-Shoqata Kosovare e të Shkurdhërve; Egzona Raçi-Sekretariati koordinues i Qeverisë; Albina Selmani, Zyra për Qeverisje të Mirë; Alberita Hyseni-Zyra Ligjore-ZKM; Rukije Gashi Shoqata Kosovare e të Shkurdhërve; Luljeta Kabashi-MASHTI; Kefsere Baftiu-Zyra për Buxeht dhe Financa-ZKM; Azem Reçica-Ministria e Financave, Punës dhe Transfereveve.
Informata shtesë	Objektivat strategjike dhe specifike janë bazuar në Strategjisë për të Drejtat e Personave me Aftësi te Kufizuar 2025-2030 si dhe Planit të Veprimit për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar 2025-2027, po ashtu edhe strategjinë e Arsimit 2022-2026, në fuqi. Në planin e veprimit njëri nga treguesit është Hartimi i politikave për komunitetin e personave të shurdhër. Duhet theksuar se opsioni i zgjedhur është opsioni 3, respektivisht hartimi i një ligji të ri për gjuhën e shenjave. Gjithashtu, elaborimi i opsionit të zgjedhur dhe krahasimi me opsionet e tjera është i bazuar në praktikat ndërkombëtare, përvojat e shteteve të tjera dhe raportet si dhe dëshmitë, të cilat dëshmojnë gjendjen e personave të shurdhër në Republikën e Kosovës.

Kapitulli 1: Përkufizimi i problemit

Vështrime hyrëse për përkufizimin e problemit

Gjuhët e shenjave kryejnë një sërë funksionesh të ngjashme me gjuhët e folura: komunikimi, përcjellin marrëdhëniet shoqërore,shprehin identitetin kulturor, ofrojnë një burim kënaqësie përmes formave artistike të të shprehurit.[1] Gjuhët e shenjave ndryshojnë në mënyrë të dukshme nga gjuhët e folura në disa mënyra, por të dy modalitetet janë po aq të vlefshme si mjete komunikimi. Ndër të tjera Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara përcakton: Neni 2 - ***Përkufizimet*** "Gjuha" përfshin gjuhët e folura dhe gjuhën e shenjave dhe forma të tjera të gjuhës jo- të folur.

Një përceptim për gjuhët e shenjave është se ato përdorin vetëm gjestikulacionin, ose pantomime. Ashtu si gjuhët e folura, gjuhët e shenjave kanë një fjalor konvencional dhe kanë treguar se kanë sisteme komplekse gramatikore. Gjuhët natyrore të shenjave nuk janë shpikur nga dikush, por kanë evoluar midis njerëzve që nuk dëgjojnë. Gjuhët e folura dhe gjuhët e shenjave ndryshojnë nga njëra-tjetra për sa i përket modalitetit që përdorin. Gjuhët e folura përdorin kanalin auditor-vokal, ndërsa gjuhët e shenjave janë gjuhë vizuale-gjesturale. Ashtu si fjalët e një gjuhe të folur shpesh mund të ndahen në njësi më të vogla (për shembull, tingujt e fjalës), shenjat përbëhen nga njësi më të vogla strukturore, të tilla si forma e dorës, orientimi, lëvizja dhe vendi i artikulimit të shenjës, si dhe elemente jo-manuale siç janë shprehjet e fytyrës. Gramatikat e gjuhëve të shenjave përdorin shprehjet e fytyrës dhe lëvizjet e trupit dhe përdorin hapësirën para dhe

[1]The status of sign languages in Europe- f.9.

përreth personit që bën shenja në mënyra të veçanta. Gjuhët e shenjave nuk duhet të ndryshohen për t'u përshtatur në strukturën e një gjuhe të folur.

Andaj, duke u bazuar në të dhënat e mësipërme hyrëse është shumë me rëndësi që statusi i gjuhës së shenjave të jetë i rregulluar në mënyrë sa më precize dhe të qartë, me një ligj të miratuar nga Parlamenti.

Nuk ka dilemë që përkufizimi i problemit duhet të nisë duke parë gjendjen në Kosovë dhe politikat e ndërtuara përsa i takon gjuhës së shenjave. Përgjitheësisht për të parë një përkufizim të qartë të problemit, duhet pasur parasysh problemin kryesor, shkaqet e këtij probblemi si dhe efektet që mund të lindin për shkak të problemit. Po ashtu, e rëndësishme është edhe identifikimi i palëve të interesuara që mund të ndihmojnë në kryerjen e problemit.

Kosova nuk ka akoma një ligj të veçatë për gjuhën e shenjave. Mospasja e një ligji në vetevetë është problemi. Mungesa e një ligji për gjuhën e shenjave, në vazhdimësi ka vështirësuar pozitën e komunitetit të personave të shkurdhër në Kosovë. Kjo sepse, të drejtat e personave të shurdhër, qasja në shoqëri, arsim, shëndeteësi, informacion, janë shumë më të vështira në mungesë të dispozitave obligative të një akti që është ligj. Mospasja e një ligji ka mundësuar që të ketë më shumë diskriminim për personat e shurdhër, sepse politikat shtetërore, në mungesë të ligjit, nuk mund të marrin formën e e duhur dhe nuk mund të kenë efekt sikurse do të kishte një ligj.

Gjuha e shenjave kosovare (GjShK) dhe konteksti i përkufizimit të problemit

Në kuptim të hartimit të këtij koncept dokumenti, duhet të theksohet se gjuha e shenjave mbetet një sfide në vete në Republikën e Kosovës. Këtë e ka treguar, veçanërisht edhe konsultimet e organizuara me akterët dhe Shoqatën Kosovare të të Shurdhërve (SHKSH), me qëllim të hartimit dhe finalizimit të këtij koncept dokumenti.[2] Në takimet konsultative të mbajtura me SHKSH, ndër të tjera janë ngritur me të drejtë shqetësimet për situatën e personave të shurdhër në Kosovë si dhe mbi të gjitha mungesën e qasjes së kësaj kategorie, për shkak të pamundësisë së komunikimit në gjuhën e shenjave dhe kjo ka shkaktuar, mbi të gjitha izolimin social të një numri të konsiderueshëm të personave të shurdhër.[3]

GjShK, është një gjuhë natyrore e komunitetit të shurdhër të Kosovës dhe është me rëndësi të njihet në këtë nivel. Qeveria e Kosovës e ka njohur gjuhën e shenjave kosovare më 29 shtator 2010[4]. Është vlerësuar se gjuha e shenjave në Republikën e Kosovës është gjuha amtare/gjuha e parë për 5,000 njerëz të shurdhër në Kosovë. Bazuar në raportin e gjendjes së të shurdhërve në Republikën e Kosovës (2010)[5], 99% e të anketuarve thonë se e preferojnë gjuhën e shenjave si mënyrën e tyre të komunikimit dhe 1% thonë se e preferojnë ta përdorin gjuhën e të folurit dhe të shenjave. Kjo është një argument i rëndësishëm për nevojën e gjuhës së shenjave, për personat e shurdhër.

---

[2] Takimi konsultativ i mbajtur me Shoqatën Kosovare të Shurdhërve (SHKSH), datë 13.09.2024.

[3] Po aty.

[4] Vendimi i Qeverisë Nr. 06/146 i datës 29.09.2010 për Zyrtarizmin e Gjuhës së Shenjave në Republikën e Kosovës.

[5] Raport i statusit te personave te shurdhër ne Republikën e Kosovës, 2010, https://www.shksh.org/wp-content/uploads/2018/11/Raport-i-statusit-te%CC%88-personavete%CC%88-Shurdhe%CC%88r-ne%CC%88-Republike%CC%88n-e-Kosove%CC%88s.pdf

Gjuha e shenjave kosovare përdoret edhe nga personat gjysmë të shurdhër ose edhe nga personat që dëgjojnë, për shembull, anëtarët e familjes së personave të shurdhër, miqtë, bashkëpunëtorët, interpretët e gjuhës së shenjave dhe entuziastët e gjuhëve të tjera.

Ashtu si gjuhët e tjera të shenjave, gjuha e shenjave kosovare është gjuhë natyrore me gramatikën dhe strukturën e vet. Shoqata Kosovare e të Shurdhërve (ShKSh) me përkrahjen e Shoqatës Finlandeze të të Shurdhërve (FAD) dhe Ministrisë së Punëve të Jashtme të Finlandës në vitin 2006 ka filluar me punën mbi gjuhën e shenjave për ta dokumentuar GjShK si gjuhë amtare të komunitetit të shurdhër në Kosovë. Si rezultat i punës, në vitin 2012 ShKSh e ka prodhuar fjalorin e parë të gjuhës kosovare të shenjave (Libri dhe DVD). ShKSh-ja ka vazhduar me dokumentimin e GjShK dhe ky fjalor elektronik[6] është rezultat i punës së vazhdueshme. Ky fjalor elektronik do të përditësohet po ashtu duke e shtuar gamën e informacioneve.[7]

Raporti i Statusit të Personave të Shurdhër në Republikën e Kosovës, 2010, SHKSH dhe FAD, në seksioni 2.8, mbi identitetin, 87% e të anketuarve janë identifikuar si të shurdhër kurse 13% janë identifikuar gjysmë të shurdhër.[8] Kjo tregon për një numër të konsiderueshëm të personave që kanë nevojë për gjuhën e shenjave dhe që shpërfaqin vërtetë një problem në vete gjuhën e shenjave dhe mungesën e saj, për integrimin dhe statusin social të personave të shurdhër në Kosovë. Strategjia e Personave me Aftësi të Kufizuar, 2025-2027, përcakton se "Bazuar në hulumtimet e fundit të Organizatës Botërore të Shëndetësisë rreth 1.3 miliardë njerëz - ose 16% e popullsisë globale - përjetojnë një paaftësi të konsiderueshme sot. Ky numër po rritet për shkak të rritjes së sëmundjeve jo të transmetueshme dhe njerëzve që jetojnë më gjatë. Personat me aftësi të kufizuara janë një grup i larmishëm dhe faktorë të tillë si gjinia, mosha, identiteti gjinor, orientimi seksual, feja, raca, përkatësia etnike dhe gjendja e tyre ekonomike ndikojnë në përvojat e tyre në jetë dhe nevojat e tyre shëndetësore". Po kjo strategji, në lidhje me të dhënat në Kosovë përcakton: "*Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë në vitin 2024, nga të dhënat që kanë publikuar Agjensioni i Statistikave të Kosovës, thekson se 21.3% e qytetarëve jetojnë me vështirësi afatgjate. Sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2024 në Republikën e Kosovës, popullsia rezidente me vështirësi afatgjate, sipas moshës, shkallës së vështirësisë në kryerjen e aktiviteteve ditore ka rezultuar të jetë 337 mijë e 859 persona. Në raport me popullsinë totale në Kosovë, i bie 21.3 %. Ndërkaq, sipas regjistrimit të popullsisë të vitit 2011 në Kosovë, pati rezultuar që janë 93 mijë e 288 persona me vështirësi afatgjate, apo rreth 8 %*".

Në lidhje me personat e shurdhër, po ashtu duhet theksuar se shumica, gati të gjithë respodentët në Raportin e Statusit të Personave të Shurdhër në Republikën e Kosovës, 2010, respektivisht 99% janë deklaruar se ata preferojnë gjuhën e shenjave si mënyrën e tyre të komunikimit. 1% e tyre kanë deklaruar se ata preferojnë të shfrytëzojë të dyjat, të folurën dhe gjuhën e shenjave.[9] "Përveç kësaj edhe nëntë nga dhjetë respodentët janë të lindur në familjet të cilët nuk kanë anëtarë tjerë të Shurdhër. Ky nuk është numër i pazakontë, sepse në shumë kombe është e përbashkët për fëmijët e shurdhër që të jetë fëmija i vetëm i Shurdhër në familje. Kjo shpeshherë ka të bëjë me shurdhësinë dhe jo kushtimisht gjenetike mirëpo mund të jetë në saje të çështjeve të ndryshme. Po ashtu, ne vërejtëm më lartë relativisht një përqindje të lartë të fëmijëve të cilët bëhen të Shurdhër pas lindjes e cila shpeshherë shkaktohet nga infeksionet ose sëmundjet në foshnjëri".[10]

---

[6] https://www.gjshk.org/, qasur me 26.10.2024.

[7] https://www.gjshk.org/informacion/gjuha-e-shenjave-kosovare/, qasur me 26.10.2024.

[8] Raporti i Statusit të Personave të Shurdhër në Republikën e Kosovës, 2010, SHKSH dhe FAD, f.13.

[9] Po aty, f.13.

[10] Po aty, f.15.

Në linjë me këtë, në takimet konsultative, është konstatuar, duke parë përvojën e SHKSH, janë identifikuar raste kur edhe vetë prindërit hezitojnë të pranojnë që fëmija i tyre është i shurdhër.

Sipas një raporti të Këshillit të Evropës, në lidhje me gjuhën e shenjave "Kur mësimdhënësit u pyetën se çfarë duhet të ndryshojë në shkollë në mënyrë që nxënësit e Shurdhër të arrijnë më shumë, ata dhanë një listë të gjërave që ata i konsiderojnë si të rëndësishme: 1.Të ketë kurrikulë të përshtatshme për nxënësit e shurdhër; 2.Të ketë më shumë laptopë, tabletë dhe teknologji në përdorim për ta bërë mësimdhënien dhe të nxënit më tërheqës; 3.Të ketë metodologji të mësimdhënies për nxënësit e shurdhër; 4.Të ketë ekip multi-disiplinar (psikolog, logoped, pedagog); 5.Të ketë trajnim të GjSh-së për nxënësit".[11] Në këtë raport, ndër të tjera u dhanë disa rekomandime për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit dhe atë si në vijim: MASHTI duhet të ndërmarrë veprime si: *"-Të krijojë një grup punues për të zhvilluar një plan veprimi i cili më pas do të zhvilloj një plan veprimi gjithëpërfshirës për zhvillimin e QB Nëna Terezë. -Të zhvillojë një kurrikulë të përshtatur për nxënësit e shurdhër në shkollë. Kurrikula duhet të përmbajë rregullime specifike në lidhje me gjuhën e shenjave, gjuhën e shkruar shqipe dhe gjuhën angleze dhe përmbajtjet dhe shkathtësitë e tjera bazë që duhet t'u mësohen nxënësve të shurdhër. -Të hartojë një kurrikulë në gjuhën e shenjave për klasat e ulëta 1-5. -Të përfshijë gjuhën e shenjave si lëndë në programin mësimor për nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim në të gjitha nivelet e arsimit fillor dhe të mesëm të lartë. - Të organizojë klasa parashkollore për fëmijët dhe të rriturit e shurdhër për të zhvilluar shkathtësitë e gjuhës së shenjave të fëmijëve.- Të akreditojë trajnimin për GjSh-në si trajnim të vazhdueshëm të mësimdhënësve për t'u njohur si trajnim për zhvillim profesional. -Të bashkëpunojë me LSh-të për të patur module për dëmtime shqisore në trajnimin e mësimdhënësve. -Të organizojë trajnime për mësimdhënësit për arsimin dy-gjuhësor dhe si të bëhen modifikime të kurrikulës përmes Planeve Individuale Arsimore (PIA), për nxënësit e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim.-Të sigurojë që kualifikimet e kërkuara janë përmbushur gjatë punësimit të personelit të ri. -Të punësojë më shumë asistentë dhe instruktorë të klasës për t'u përfshirë në procesin e mësimdhënies dhe edukimit.- Të organizojë trajnim për asistentët e klasave të të shurdhërve në gjuhën shqipe të shkruar në mënyrë që ata të komunikojnë me mësimdhënësit që dëgjojnë dhe stafin tjetër".*[12]

Raporti i statusit te personave te shurdhër ne Republikën e Kosovës, 2010, lidhur me gjendjen e të shurdhërve në arsim thekson se 100 persona të Shurdhër pjesëmarrës në këtë hulumtim 83% kanë vijuar shkollën fillore dhe 17% e tyre nuk kanë vijuar shkollën fillore. Më shumë se gjysma e respodentëve kanë vijuar shkollën fillore për të Shurdhër në Prizren (58%), 11% kanë vijuar shkollën fillore në Prishtinë, 3 kanë vijuar shkollën fillore në Mitrovicë përderisa 11% kanë vijuar shkollat "tjera".[13] Kjo qasje tregon për gjendjen e të shurdhërve në Kosovë, përsa i takon edukimit të tyre, në mungesë të gjuhës së shenjave. Kur flasim për edukimin e personave të shurdhër, Konventa Ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar përcakton: "Neni 24 - **Arsimi** "Shtetet Palë duhet të lejojnë personat me aftësi të kufizuara të mësojnë shkathtësitë e jetës dhe zhvillimit social për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe të barabartë në arsim dhe si anëtarë të komunitetit. Për këtë qëllim, Shtetet Pjesëmarrëse duhet të marrin masa të përshtatshme, duke përfshirë: -- b) Lehtësimin e mësimit të gjuhës së shenjave dhe promovimin e identitetit gjuhësor të komunitetit të shurdhërve"

---

[11] Marja Mate; Gazmend Tahiraj "Studim mbi nivelin e arritjeve akademike të nxënësve me dëmtime në dëgjim në Qendrën Burimore Nëna Terezë në Prizren", Këshilli i Evropës. , f.42,43.

[12] Po aty, f.55.

[13] Raporti i Statusit të Personave të Shurdhër në Republikën e Kosovës, 2010, SHKSH dhe FAD, f.18.

Në një raport studimor të autores Verena Krausneker, lidhur me të drejtën për gjuhë të personave të shurdhër, ndër të tjera theksohet: "*Shumica e personave të Shurdhër nuk rriten në mjedise ku përdoren shenjat dhe zakonisht ata përjetojnë një rrugë të vështirë me përplot pengesa dhe devijime para se të përvetësojnë gjuhën e shenjave. Ata janë të lindur në familjet që dëgjojnë pa njohuri në gjuhën e shenjave dhe kulturës së Shrudhërve si dhe në shumë shtete prindërit zakonisht këshillohen që të mos i paraqesin fëmijët e tyre në komunitetin e gjuhës së shenjave. Shumica e fëmijëve të Shurdhër janë të përjashtuar nga mundësia e përvetësimit të gjuhës në moshën-adekuate dhe pa barriera. Për shumicën e fëmijëve të cilët janë të përjashtuar nga gjuhët e shenjave, kjo shkakton zhytje në përjashtimin e plotë nga gjuha vizuale e kuptueshme dhe si pasoje janë vonesat në përvetësimin e saj*"[14]. Kjo tregon qartësisht problemet dhe pengesat të cilat i shkakton gjuha e shenjave dhe mungesa e saj, në aspektin e një statusi të qartë ligjor. Kjo gjendje e paraqitur nga autorja në fjalë, sipas SHKSH është prezente edhe në Republikën e Kosovës, kjo e forcon edhe më shumë nevojën e mbështetjes së opsionit të zgjedhur. Kjo vërehet edhe në raportet të cilat jënë dhënë për Kosovën si dhe rekomandimet e cituara më sipër të dhëna për Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) në raportin e Marja Mate dhe Gazmend Tahiraj "Studim mbi nivelin e arritjeve akademike të nxënësve me dëmtime në dëgjim në Qendrën Burimore Nëna Terezë në Prizren", mbështetur nga Këshilli i Evropës.

Në kontekstin e pjesëmarrjes së personave të shurdhër në arsim, neni 24 i Konventës Ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar përcakton: "*Neni 24*: Obligon qeveritë të lehtësojnë mësimin e gjuhës së shenjave dhe të promovojnë identitetin gjuhësor të Komunitetit të Shurdhërve, për të mësuar shkathtësi për zhvillimin e jetës dhe shoqërisë për të lehtësuar pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe të barabartë në arsim dhe si anëtarë të komunitetit".

Një dimension rëndësishëm i gjuhës së shenjave, sipas raportit të autores Verena Krausneker është dhe edukimi dhe arsimimi. Ndër të tjera, në këtë raport, duke cituar një rast gjyqësor theksohet: "Është nevoja për një numër të madh të modeleve gjuhësor të Shurdhër nëpër klasa dhe këto modele duhet të demonstrojnë zotërimin dygjuhësor/bilingual. Po ashtu individët që dëgjojnë dhe punojnë në klasa duhet të demonstrojnë zotërimin dygjuhësor dhe paraqesin aftësi të larta në gjuhën e shenjave e cila rrit qasjen në informacion në klasë dhe zotësinë gjuhësore për fëmijët me dëmtim në dëgjim"[15]. Ky raport, në kuptim të trajtimit të nevojës për gjuhën e shenjave, ndër të tjera jep disa rekomandime të rëndësishme si në vijim:

- Njohja zyrtare e gjuhëve të shenjave;
- Integrimi i nevojave të përdoruesve të gjuhës së shenjave;
- Mundësojë procesin natyral të përvetësimit të gjuhës;
- Qasje e lehtë në gjuhën e shenjave për familjarët;
- Përshtatja e edukimit të Shurdhër;
- Trajnimet speciale për arsimtarët;
- Kurrikula të barabarta;
- Gjuha e shenjave si gjuhë edukimi;
- Gjuha e shenjave si lëndë në shkollë;
- Shmangia nga izolim;

---

[14] Verena Krausneker, "Mbrojtja dhe promovimi I gjuhës së shenjave dhe të drejtave të perdoruesve të saj në shtetet e këshillit Europian analizimi i nevojave", Divizioni I Integrimit të Personave me Aftësi të Kufizuara Departamenti I Politikave Sociale Drejtorati i Përgjithshëm I Kohezionit Social Këshilli I Europës, 2008, f.16.

[15] Po aty, f.19

- Qasje në edukimin e lartë;
- Informacion pa barriera dhe lajmet;
- Teknologjia përkundër barrierave;
- Interpretimi profesional i gjuhës së shenjave[16]

Disa rekomandime, siç është për shembull pjesa e interpretimit të gjuhës së shenjave dhe ofrimi i shërbimeve kanë gjetur zbatim në Kosovë. Po ashtu Republika e Kosovës ka zyrtarizuar gjuhën e shenjave, por megjithatë ideja që të ketë një opsion të ri, synon që të zbatoj në mënyrë më gjithëpërfshirëse këto rekomandime.

Duke trajtuar efektin e mungesës së gjuhës së shenjave në arsim, Udhëzuesi për Edukimin Gjithëpërfshirës, Bilingualizmin dhe Gjuhën e Shenjave për Fëmijët me Dëmtime në Dëgjim, 2019 trajton efektin domino që ka për personat e shurdhër mungesa e gjuhës së shenjave për personat e shurdhër.

Ndër të tjera, ky udhëzues thekson: " Humbja e dëgjimit ndikon në zhvillimin e aftësive komunikuese dhe ekspresive të komunikimit, të cilat mund të çojnë në njohuri të reduktuara të sfondit dhe të nxënit rastësor. Vështirësitë e komunikimit (mungesa e gjuhës së shenjave) shpesh çojnë në izolimin social dhe varfërimin e vetë-konceptit dhe mund të kenë ndikim në zgjedhjet profesionale.

Përdorimi i gjuhës pragmatike (ndërhyrjet, kërkim faljet, aftësia për të krahasuar / kontrastuar, zgjidhja e problemeve, riparimi i ndarjes së bisedave) zhvillohet më ngadalë tek fëmijët me dëmtime në dëgjim të cilët nuk kanë përvetësuar gjuhën e shenjave me kohë dhe të cilët nuk kanë patur shanse për të përdorur gjuhën e shenjave si gjuhë e mësimdhënies në ambientet arsimore.




Figura X. Efekti domino në zhvillimin gjuhësor (burimi Udhëzues për edukimin gjithëpërfshirës, bilingualizmin dhe gjuhën e shenjave për fëmijët me dëmtime në dëgjim, MASHTI 2019)

Aktualisht përfshirja e fëmijëve me dëmtime në të dëgjuar në institucione arsimore është jo e kënaqshme dhe mjaft sfiduese, kryesisht janë të përfshirë në Qendra Burimore dhe në disa qendra edukative.[17]. Siç mund të shuhet në figurën e paraqitur, efekti më i rëndë për personat e shurdhër dhe mungesën e gjuhës së shenjave është izolimi i tyre. Edhe pse nuk ka një statistikë të saktë që ndërlidhet me efektin e izolimit, i

[16] Po aty, 23-29.

[17] Udhëzues për Edukimin Gjithëpërfshirës, Bilingualizmin dhe Gjuhën e Shenjave për Fëmijët me Dëmtime në Dëgjim, 2019, MASHTI dhe SHKSH, f.13.

njëjti është evident, për shkak të efektit ë në zhvillimin gjuhësor të fëmijëve të shurdhër. Kjo i pamundëson ata/ato fëmijë që të qasen normalisht në procesin arsimor.

Në kontekst të kësaj pjesëtarët e komunitetit të shurdhër mund të konsiderohen si të margjinalizuar në aspektin arsimor dhe të diskriminuar social në shoqërinë kosovare.[18] Siç mund të shihet diskriminimin e tyre e prodhon mungesa e një qartësie të statusit të gjuhës së shenjave. Diskriminimi në këtë rast ndodh mbi bazën e të qenit person me aftësi të kufizuar. Ajo çfarë mund të thuhet është se të pasurit një ligj të gjuhës së shenjave do të forconte mekanizmat dhe minimizonte diskriminimin. Lidhur me diskriminimin e personave të shurdhër, Konventa Ndërkombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuar përcakton: "**Neni 23:** Kërkon që qeveritë të marrin masa efektive dhe të përshtatshme për të eliminuar diskriminimin kundër personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë edhe personat e shurdhër, në çdo çështje që lidhet me martesën, familjen, prindërimin dhe marrëdhëniet, në bazë të barabartë me të tjerët".

Ndërlidhur me nevojën e gjuhës së shenjave, Federata Botërore e të Shurdhërve ka dhanë rekomandimet konkrete, si në vijim:


- Të njohin gjuhët kombëtare të shenjave si një nevojë thelbësore shëndetësore për të gjithë fëmijët që nuk dëgjojnë dhe të zbatojnë politika që sigurojnë akses në gjuhët e shenjave për të gjithë fëmijët që nuk dëgjojnë;
- Ofrimi i shërbimeve kombëtare të gjuhës së shenjave për fëmijët që nuk dëgjojnë dhe familjet e tyre si pjesë e sistemeve të shëndetit publik dhe sigurimit shëndetësor;
- Sistemet e edukimit dhe kujdesit në fëmijërinë e hershme të ofrojnë qasje në të dhëna të rrjedhshme kombëtare të gjuhës së shenjave dhe ndërveprime të pasura e të shumta me profesionistët që nuk dëgjojnë dhe anëtarët e komunitetit;
- Ndërhyrja e hershme dhe shërbimet e gjuhës së shenjave të udhëhiqen nga profesionistë të shurdhër dhe anëtarë të komunitetit, mësues të gjuhës së shenjave të shurdhër dhe organizata mbrojtëse të të shurdhërve;
- Profesionistët e shërbimeve shëndetësore, mjekësore dhe sociale të ofrojnë informacion të saktë dhe të duhur mbi gjuhët kombëtare të shenjave dhe të promovojnë aksesin dhe mësimin e lirë të fëmijëve të shurdhër dhe familjeve të tyre në gjuhë(t) kombëtare të shenjave që nga mosha më e hershme e mundshme.[19]

Në kontekstin e Republikës së Kosovës, në vitin 2014 është aprovuar Rregullorja **QRK Nr.15/2014[20] për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave në Republikën e Kosovës dhe në fillim të vitit 2016**, Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) në koordinim me SHKSH-në, në bazë të nenit 4 të rregullores ka filluar që të ofrojnë shërbime në gjuhën e shenjave në të gjitha institucionet publike të Republikës së Kosovës.

Ky koordinim bëhet bazuar në zbatimin e Rregullores QRK 15/2014 për Ofrimin e Shërbimeve në Gjuhën e Shenjave. Përshkrimi i të arriturave lidhur me këtë aktivitet raportohet se janë ofruar shërbimet e nevojshme bazuar në kërkesat e komunitetit te personave të shurdhër për vitin 2024. Në diagramin e më poshtëm janë të paraqitura disa të dhëna të ofruara nga Zyra për Qeverisje të Mirë / Zyra e Kryeministrit

[18] Karin Hoyer "Language Vitalization through Language Documentation and Description in the Kosovar Sign Language Community", 2013, p.15-16.
[19] Position Paper-on access to National Sign Languages as a Health Need, WFD, 2022, p.5
[20] https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10363 , qasur me 26.10.2024.


(ZQM/ZKM) në bashkëpunim me Shoqatën Kosovare të Shurdhërve (ShKSh) gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025, lidhur me shërbimet e gjuhës së shenjave të ofruara nga interpretët profesionist të gjuhës së shenjave. Të dhënat janë mbledhur nga lista e prenotimeve dhe lista e pagesave për shërbimet e ofruara. Gjatë vitit 2025 janë ofruar gjithsejtë 5072 orë shërbime ne gjuhen shenjave ne vlerë prej 50,720 Euro.



Shërbimet në Gjuhën e Shenjave të ofruara gjatë viti 2025

Vlen te theksohet se qe nga fillimi zbatimit te rregullores në fjalë personat e shurdhër ne te gjithë Republikën e Kosovës marrin shërbime ne çdo institucion publik ne vend. Tabela më poshtë paraqet te dhënat se ne baze te përqindjes ku janë ofruara Shërbimet e Interpretëve ne cilat institucione me konkretisht gjate viti 2025.

Institucionet ku janë ofruar shërbimet e interpretëve



Të dhënat në përqindje % se ku janë ofruar shërbimet ne gjuhen e shenjave ne institucionet publike

Duke parë problemin dhe rëndësinë e problemit nga sa u tha më sipër, aprovimi i ligjeve të gjuhës së shenjave është një hap i rëndësishëm drejt sigurimit të të drejtave dhe pjesëmarrjes së barabartë për komunitetin e shurdhër dhe se deri më tani një politikë e tillë nuk ekziston.

Megjithëse është bërë një punë e madhe në sektorin publik, është e rëndësishme të theksojmë se kjo rregullore nuk përfshin sektorin privat përfshirë dhe shërbimet e noterisë, QAP (shërbimet e interpretimit pranë Qendrave për Aftësim Profesional, në shume raste dhe shërbimet universitare për shkak të autonomisë financiare të universiteteve dhe mungesës së legjislacionit për gjuhën e shenjave.

Komuniteti i të shurdhërve me vite të tëra ka shprehur nevojën dhe kërkesën që shërbimet në gjuhën e shenjave të zgjerohen edhe në sektorin privat, përfshirë noterët, bankat, spitale private, dhe shumë të tjera.

Përveç tjerash, personat e shurdhër në Republikën e Kosovës, përpos mungesave legjislative dhe politikave, ata/ato kanë edhe mungesë në mekanizma dhe softverë adekuat që mundësojnë qasjen e lehtë për personat e shurdhër. Në mungesë të një qasje të tillë të ofrimit të shërbimit për këtë kategori, shumë shërbime, në çdo aspekt kanë bërë që personat e shurdhër të ndihen të diskriminuar dhe këtë e konstatojnë edhe raportet dhe referencat e mësipërme. Lidhur me qasjen, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara përcakton në nenet 9 dhe 21 përcakton: "*Neni 9 - **Qasja** "Shtetet Palë duhet të marrin masa të përshtatshme: -- e) Të siguruar forma asistence direkte dhe të ndërmjetme, duke përfshirë guida, lexues dhe interpretë profesionistë të gjuhës së shenjave, për të mundësuar qasjen në ndërtesa dhe objekte të tjera publike;" Neni 21 - **Liria e shprehjes dhe mendimit, dhe qasja në informacion** "Shtetet Palë duhet të marrin të gjitha masat e përshtatshme për të siguruar që personat me aftësi të kufizuara mund të ushtrojnë të drejtën e lirisë së shprehjes dhe mendimit, duke përfshirë lirinë për të kërkuar, marrë dhe shpërndarë informacione dhe ide në bazë të barabartë me të tjerët dhe përmes të gjitha formave të komunikimit të zgjedhur nga personi,*

siç është përcaktuar në nenit 2 të kësaj Konvente, duke përfshirë: --- b) Pranimin dhe lehtësimin e përdorimit të gjuhëve të shenjuara, -- e) Njohja dhe promovimi i përdorimit të gjuhëve të shenjuara."

Mungesa e një baze ligjore adekuate në Republikën e Kosovës, për gjuhën e shenjave ka sjellur në rezultat që shumë mekanizma përkatës të cilët ndihmojnë personat e shurdhër dhe që implementojnë gjuhën e shenjave, të mungojnë. Lidhur me mbrojtjen ligjore, Konventa për Personat me Aftësi të Kufizuar, në nenin 5 përcakton: "***Neni 5*** Kërkon që qeveritë të ndalojnë të gjitha diskriminimet në bazë të aftësisë dhe të sigurojnë për personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë edhe personat e shurdhër, mbrojtje ligjore të barabartë dhe efektive kundër diskriminimit në të gjitha aspektet". Po ashtu lidhur me këtë çështje neni 12 i kësaj konvente përcakton "***Neni 12:*** Kërkon që qeveritë të sigurojnë që personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë edhe personat e shurdhër, të gëzojnë kapacitet ligjor në bazë të barabartë me të tjerët në të gjitha aspektet e jetës".

Shikuar në një perspektivë krahasimore në Evropë dhe regjion, shtetet e ndryshme kanë aprovuar ligje të posaçme për ofrimin e shërbimeve nëpërmjet internateve ne gjuhës së shenjave, të cilat rregullojnë dhe përcaktojnë shërbimet në gjuhën e shenjave për qytetarët e tyre respektivë. Një perspektive e tillë krahasimore do të prezantohet edhe në vijim për të parë mënyrën se si trajtohet gjuha e shenjave, në përgjithësi, në disa shtete dhe për të aplikuar këto praktika në Kosovë.

Bazuar në perspektivën krahasimore në disa vende, referencat e mësipërme si dhe konsultimet me shoqatën e të shkurdhërve të Kosovës është evidente që në Republikën e Kosovës mungon një ligj i cili trajon gjuhën e shenjave, pasiqë ky ligj do të mundësonte respektimin e dinjitetit dhe do të mundësonte përfshirjen e barabartë të komunitetit të të shurdhërve në shoqëri dhe se ligji do të krijonte mundësinë e ofrimit të shërbimeve të interpretimit të gjuhës së shenjave, për personat që nuk dëgjojnë. Mbi të gjitha do të mundësonte një trajtim dinjitoz të personave të shurdhër në Kosovë, duke pasur paraysh nevojat e tyre.

Figura 2: Dokumentet përkatëse të politikave, ligjet dhe aktet nënligjore

Dokument i politikave, ligj ose akti nën-ligjor	**Lidhja me politikën apo dokumentin planifikues përmes internetit ose me aktet ligjore në Gazetën Zyrtare**	**Institucioni(-et) shtetëror (e) përgjegjës(e) për zbatim**	**Roli dhe detyrat e Institucionit(-eve)**
Ligji Nr 04/L-032 Për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës	Datë: 02 (rks-gov.net) Datë: 02 (rks-gov.net)	Të gjitha institucionet parauniversitare në Republikën e Kosovës	Neni 43 **Gjuha e shenjave dhe sistemi Brejll (Braille)** 1. Nxënësve dhe fëmijëve të cilët përdorin gjuhën e shenjave si gjuhë të tyre të parë, duhet t'u ofrohetmësimdhënie për përdorimin e gjuhës së shenjave dhe përmes mënyrës së gjuhës së shenjave.

			2. Ministria mund të vendosë që mësimdhënia nëpërmjet gjuhës së shenjave dhe për përdorimin e gjuhës së shenjave të ofrohet në një lokacion jashtë institucionit të zakonshëm të nxënësve.
Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Ligji Nr 03/L-019, për aftësim dhe riaftësim profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara	https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2620	MFPT QAP QRPK QRP ZKP	Neni 4, paragrafi 1.4 1.4. nxënësi prej moshës pesëmbëdhjetë (15) deri tetëmbëdhjetë (18) vjeç, me aftësi te kufizuar mendore, fizike, psikike ose te kombinuara sipas dispozitave ligjore te aplikueshme për shkollimin e mesëm, duke i siguruar atij që ka nevojë edhe gjuhën e shenjave për personin e shurdhët.
Rregullore QRK Nr. 15/2014	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=10363	Zyra për Qeverisje të Mirë në kuadër të zyrës së Kryeministrit Të gjitha institucionet publike në Republikën e Kosovës	Rregullorja përcakton rregullat dhe procedurat për ofrimin e shërbimeve në Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës si dhe qasje në shërbimet e interpretimit, nëpërmjet Interpretëve të Gjuhës së Shenjave për Personat e Shurdhër në Republikën e Kosovës
Udhëzim administrativ nr 26/2012 për kualifikimin për personelin që punon me nxënësit me nevoja arsimore	https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=9924	MASHTI	Neni 3, paragrafi 8, Ky nen përcakton interpretimin e gjuhës se shenjave si kategori.
Vendim i Qeverisë Nr 06/146	https://gzk.rks-gov.net/ActsByCategoryInst.aspx?Index=3&InstID=3&CatID=30	Zyra e Kryeministrit Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore	Ky vendim obligon Zyrën e Kryeministrit/Zyrën për Qeverisje të Mirë të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Çështje Gjinore të hartoj Politikë të Veprimit për zbatimin

			e këtij vendimi, monitorimin dhe raportimin e gjithë procesit
PROGRAMI KOMBËTAR PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE NË GJUHËN E SHENJAVE PËR PERSONAT E SHURDHËR NË REPUBLIKËN E KOSOVËS (2013-2016)	https://www.shksh.org/wp-content/uploads/2018/11/Programi-kombe%CC%88tar-pe%CC%88r-ofrimin-e-she%CC%88rbimeve-ne%CC%88-gjuhe%CC%88n-e-shenjave-pe%CC%88r-personat-e-shurdhe%CC%88r-ne%CC%88-Republike%CC%88n-e-Kosove%CC%88s.pdf	Zyra e Kryeministrit Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta	QËLLIMI Qëllimi i këtij programi është që të krijojë një shoqëri gjithëpërfshirëse e cila do të rrisë pjesëmarrjen e komunitetit të personave të shurdhër në të gjitha sferat e jetës në Republikën e Kosovës. Pra si indikatorë i këtij dokumenti është mobilizimi i të gjithë institucioneve publike në vend për të hequr pengesat, të cilat në këtë rast janë komunikuese, që do të siguroj në të ardhmen pjesëmarrjen e plotë të personave të shurdhër. Ky program do të fokusohet kryesisht në dy fusha që kanë për qëllim ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave si dhe mësimin në gjuhën e shenjave. Ofrimi i shërbimeve do të arrihet përmes krijimit të një njësie për ofrimin e shërbimeve në gjuhën e shenjave nga ku do të shërbehen të gjitha institucionet e vendit për çdo nevojë komunikuese që kanë qytetarët e saj.
Udhëzimi Administrativ për Normativin mbi kuadrin profesional të arsimit, 05/2021 MASHTI	https://masht.rks-gov.net/udhezimi-administrativ-mashti-nr-05-2021-per-normativin-mbi-kuadrin-profesional-te-arsimit-te-pergjithshem/	Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI)	Neni 8 (par 7, 8,9) i këtij Udhëzimi administrativ, njeh si kuadër profesional në shkolla: Instruktorin e gjuhës së shenjave, interpretuesin e gjuhës së shenjave dhe asistentin e Gjuhës së Shenjave.
STRATEGJIA PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË		Zyra e Kryeministrit Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta	Të tilla janë: barrierat strukturore në objektet e ndërtuara, mungesa në planifikim urbanistik, enterierët e planifikuar gabimisht, ueb-sajtet që nuk plotësojnë standardet e

KUFIZUAR 2025-2030			qasshmërisë, mungesa e programeve me titra, mungesa e programeve të mjaftueshme në gjuhën e shenjave dhe me audio-përshkrim, mungesa e dokumenteve dhe librave në audio-format apo shkrimin Braille, apo në formatin për lexim të lehtë, etj
PLANI I VEPRIMIT PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR 2025-2027		Zyra e Kryeministrit Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta	Hartimi i koncept dokumentit të Ligjit për shërbimet në gjuhën e shenjave. Objektivi specifik I.1 Përmirësimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse sociale për personat me aftësi të kufizuar

Në konsultimet e zhvilluara, ndër problemet që i hasin personat e shurdhër, në mungesë të gjuhës së shenjave janë:

- Problemet në edukim, në mungesë të gjuhës së shenjave dhe rrjedhimisht izolimi;
- Rrezikimi i shëndetit të personave të shurdhër, në mungesë të marrjes së informacioneve të duhura përmes shërbimeve shëndetësore;
- Arritja e efektit domino të mungesës së gjuhës së shenjave, që dërgon në izolim;
- Mungesa jashtë zakonisht e ulët e numrit të interpretove të gjuhës së shenjave në Kosovë, rreth 16 prej tyre;
- Avancimi teknologjik i nevojave për gjuhën e shenjave.

Gjuha e shenjave në perspektivën e aspekteve ndërkombëtare

Gjuha e shenjave dhe hulumtimet e kaluara për gjuhën e shenjave më parë, kanë treguar qartë se ka qindra gjuhë të shenjave nëpër botë e të cilat dallojnë nga vendi në vend. Madje edhe pse Austria dhe Gjermania përshembull kanë të njëjtën gjuhë të folur, ato kanë gjuhë të shenjave të ndryshme.[21] Nuk ka dilemë që kur flitet për gjuhën e shenjave, personat e shurdhët zënë një vend të rendësishëm në këtë aspekt dhe zakonisht njerzit e shurdhër e indetifikojnë vetëm si pjesë e një pakice gjihësore dhe kulturore, megjithatë ka argumente që gjuhët e shenjave nuk konsiderohen gjuhë të pakicave.[22]

Në kuadër të praktikave ndëkrombëtare lidhur me gjihën e shenjave është me rëndësi të theksohet që, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në praktikën e saj disa vjeqare ka përdorur terminologji të ndryshme, përfshirë edhe atë shurdh-memec, megjithatë në rastin ***Gabriela Kaiser kundër***

[21] Eeva Tupi, SIGN LANGUAGE RIGHTS IN THE FRAMEWORK OF THE COUNCIL OF EUROPE AND ITS MEMBER STATES Publication of the Ministry for Foreign Affairs of Finland 2019, f.5-6.

[22] Po aty, f.7.

Zvicrës, GJEDNJ, përmirësojë terminologjinë duke përdorur atë "personat e shurdhër" ose "persona me dëgjim të dobësuar".[23]

Në kuptim të praktikave ndëkrombëtare, në disa vende të cilat janë anëtare të Këshillit të Evropës, historia e gjuhës së shenjave është mizore, në kuptim të ndalimit të përdorimit të gjuhës së shenjave sepse disa vende anëtare të Këshillit të Evropës, personat e shurdhër edhe sot përballen me pengesa dhe situata diskriminuaese, përfshirë edhe qasjen në punësim dhe qasjen e e pamjaftueshme dhe të dobët në arsim.[24]

Praktikat ndëkrombëtare, lidhur me aspektine rregullitmit të gjuihës së shenjave, në aspektin krahasimor, shkojnë në dy drejtime: e para ka shtete të cilat nuk ka një ligj për gjuhën e shenjave, e që janë: Mali i Zi, Italia, Armenia, Azerbejxhani, Zvicra, Holanda etj. Megjithatë ka shtesë, si Kroacia, Sllovenia që me ligj të caktuar e njohin gjuhën e shenjave si kategori në nivelin kombëtar.[25]

Në kuptim të trajtimit të problemit kryesor, të koncept dokumentit për gjuhën e shenjave, janë të rëndësishme edhe standardet tjera ndërkombëtare. Kështu Konventa ndërkombëtare e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara (KNPAK) është traktati ndërkombëtar që njeh gjuhën e shenjave si gjuhë. Në aspektin e akteve ndërkombëtare, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Protokolli Opsional ndër të tjera në nenin 2 përcakton: "*Komunikimi" përfshin gjuhët, shfaqje teksti, Braille, komunikimin me prekje, printim me font të madh, multimedia të aksesueshme, si edhe gjuhë të qartë, audio dhe të shkruar, lexuesin (person që lexon) dhe mënyra, mjetet dhe forma komunikimi shtesë apo alternative, duke përfshirë informacion dhe teknologji komunikimi të aksesueshëm*". Ky përcaktim nënkupton detyrimin e komunikimit përmes gjuhës së shenjave. Në anën tjetër, ku dokument, në kuptimin e lirisë së shprehjes dhe mendimit, përsa i takon gjuhës së shenjave, në nenin 21 përcakton "*Ndërmarrjen e të gjitha masave për Pranimin dhe lehtësimin e përdorimit të gjuhës së shenjave, gjuhës Braille, komunikimit shtesë dhe alternativ dhe të të gjitha mjeteve, mënyrave, dhe formave të tjera të komunikimit të aksesueshme sipas zgjedhjes së personave me aftësi të kufizuar në komunikimet zyrtare*". Gjithashtu ky instrument ndërkombëtar, promovon gjuhën e shenjave edhe në nenin 23 paragrafi 3 pika a, dhe paragrafi 4, respektivisht në fushën e arsimit. Paragrafi 4 i kësaj konvente, në kontekst të gjuhës së shenjave përcakton "Me qëllim që të garantohet realizimi i kësaj të drejte, Shtetet Palë do të marrin masat e duhura për punësimin e mësueseve, duke përfshirë mësuesit me aftësi të kufizuar, të cilët janë të kualifikuar në gjuhën e shenjave, dhe të trajnojnë profesionistët dhe stafin që punon në të gjitha nivelet arsimore. Trajnime të tilla duhet të përfshijnë ndërgjegjësimin në lidhje me aftësinë e kufizuar dhe përdorimin e mënyrave të duhura augmentative/njohëse dhe alternative, mjeteve dhe formateve të komunikimit, teknikave edukuese dhe materialeve për të mbështetur personat me aftësi të kufizuar". Po ashtu, Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara përcakton: "***Neni 12:*** *Kërkon që qeveritë të sigurojnë që personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë edhe personat e shurdhër, të gëzojnë kapacitet ligjor në bazë të barabartë me të tjerët në të gjitha aspektet e jetës;* ***Neni 20:*** *Kërkon që qeveritë të marrin masa efektive për të siguruar lëvizjen personale me pavarësi maksimale për personat me aftësi të kufizuara, duke përfshirë edhe personat e shurdhër;* ***Neni 29:*** *Kërkon që qeveritë të garantojnë dhe të promovojnë një mjedis që siguron pjesëmarrje*

---

[23] CASE OF GABRIELA KAISER v. SWITZERLAND, App. No(s). 35294/11

[24] Eeva Tupi, SIGN LANGUAGE RIGHTS IN THE FRAMEWORK OF THE COUNCIL OF EUROPE AND ITS MEMBER STATES Publication of the Ministry for Foreign Affairs of Finland 2019, f.9.

[25] Po aty, f.25.

efektive dhe të plotë në jetën politike dhe publike në bazë të barabartë me të tjerët, duke përfshirë dhe mundësinë".

Një dokument i rëndësishëm i cili ofron një mbështetje për gjuhën e shenjave është edhe direktiva 2019/882 e parlamentit evropian mbi kërkesat e qasjes në produktet dhe shërbimet, e datës 17 prill 2019.[26] Kjo direktivë mundëson që përmes produkteve dhe shërbimeve të ofrojë qasje edhe për personat e shurdhër përmes gjuhës së shenjave. Ndër të tjera kjo direktivë përcakton: "(b) Shërbimet që ofrojnë akses në shërbimet e mediave audiovizive: (i) ofrimin e udhëzuesve elektronikë të programeve (EPG) të cilët janë të perceptueshëm, të operueshëm, të kuptueshëm dhe të fuqishëm dhe të sigurojë informacion në lidhje me disponueshmërinë e aksesit; (ii) sigurimi që komponentët e aksesueshmërisë (shërbimet e aksesit) të shërbimeve të medias audiovizive, si titrat për personat e shurdhër dhe me vështirësi në dëgjim, përshkrimi audio, titrat e folur dhe interpretimi i gjuhës së shenjave të transmetohen plotësisht me cilësinë e duhur për shfaqje të saktë dhe të sinkronizuara me zëri dhe video, duke lejuar kontrollin e përdoruesit të shfaqjes dhe përdorimit të tyre".[27] Po ashtu direktiva si shërbime të veçanta përcakton që personat e shurdhër të mund të përdorin gjuhën e shenjave për të komunikuar mes tyre.[28]

Në rast të zbatimit të opsionit të propozuar, duhet theksuar që duhet të merret parasysh direktiva përkatëse.

Në aspektin e akteve ndërkombëtare, dokumente të rëndësishme ndërkombëtare relevante janë edhe: Rezoluta e Bashkimit Evropian 1988 dhe rezoluta e Bashkimit Evropian 1998 mbi gjuhët e shenjave dhe rezoluta e Bashkimit Evropian e 23 nëntorit 2016 mbi gjuhët e shenjave dhe interpretët profesionist të gjuhës së shenjave[29].

Po ashtu, në aspektin e përmbushjes së standardeve ndërkombëtare, duhet theksuar se është realizuar një hulumtim i fundit rreth standardeve ndërkombëtare se ku qëndron Kosova, duke vlerësuar legjislacionin e Kosovës nga pikëpamja e Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar dhe Acquis Communautaire të Bashkimit Evropian, në fushat: 1. Të drejtës për jetë dhe drejtësi, 2. Pavarësia, privatësia, familja dhe jeta në komunitet, 3. Qasshmëria, 4. Edukimi, 5. Liria, mbrojtja nga tortura, integrite dhe lëvizshmëria, 6. Barabarësia, mos-diskriminimi (gratë dhe fëmijët), 7. Shëndeti, 8. Punësimi dhe kujdesi social, 9. Pjesëmarrja publike, 10. Statistikat dhe bashkëpunimi ndërkombëtarë. Ky raport paraqet se më pak se një e treta (30.72%) e detyrimeve (standardeve) të vlerësuara ndërkombëtare të aftësisë së kufizuar janë te përfshira plotësisht në legjislacionin e Kosovës. Pjesa tjetër, rreth 70% të detyrimeve i përkasin kategorive të vlerësimit pjesërisht të adresuara (50.00%) dhe atyre që mungojnë (19.28%). Qasja mbetet kategoria më sfiduese, me vetëm 6.77% të standardeve të përfshira plotësisht në legjislacion[30].

---

[26] DIRECTIVE (EU) 2019/882 OF THE EUROPEAN PARLIAMENT AND OF THE COUNCIL of 17 April 2019 on the accessibility requirements for products and serviles ETSI EN 301 549 - V3.2.1 (2021-03) - Accessibility requirements for ICT products and serviles, https://eur-lex.europa.eu/eli/dir/2019/882/oj qasur me 27.10.2024.

[27] Po aty, f.103.

[28] Po aty, f.110.

[29] https://www.europarl.europa.eu/doceo/document/TA-8-2016-0442_EN.html?redirect

[30] Raport hulumtues 'Standardet Nderkombetare mbi Ceshtjen e Aftesise se Kufizuar. Ku qendron Kosova?, 2022, https://handi-kos.org/wp-content/uploads/2004/03/Research_Report_Ku-qendron-Kosova_ALB_publication_2020.pdf

Një gjë e tillë paraqet një shqetësim të arsyeshëm, në perspektivën e ndërtimit të një segmenti të rëndësishëm, respektivisht të një çështje të rëndësishme për personat e shurdhër dhe ata të verbër, lidhur me gjuhën e shenjave dhe ndërtimin e politikave të rëndësishme legjislative.

Ndër të tjera, lidhur me përkufizimin e problemit përsa i përket gjuhës së shenjave, sipas Federatës Botërore të Shurdhërve (WFD)[31] 77 shtete kanë njohur gjuhën e shenjave në legjislacionet përkatëse. Disa prej shteteve e kanë të njohur gjuhën e shenjave në kushtetutë, disa në ligje të përgjithshme të gjuhëve, shumica e shteteve e kanë të njohur në ligjin e e gjuhës së shenjave, disa e kanë të përfshirë në ligjin e aftësisë së kufizuar etj.

Një perspektive krahasimore e gjuhës së shenjave

Është e rëndësishme, për qëllimet e këtij koncept dokumenti të paraqesim një perspektive krahasimore, përsa i takon gjuhës së shenjave dhe mënyrat e trajtimit të gjuhës së shenjave në këto shtete. Perspektiva krahasimore do të përcaktojë një shtet Evropian (Finlanda) dhe Republikën e Shqipërisë, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut. Këto praktika krahasimore janë trajtuar ndër të tjera, më gjerësisht në dokumentin "STUDIM MBI PRAKTIKAT MË TË MIRA PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE TË INTERPRETIMIT TË GJUHËS SË SHENJAVE NË BALLKAN DHE EVROPË, Maj 2023 i realizuar nga Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që Nuk Dëgjojnë (ANAD) me ndihmën e UNDP-së, si pjesë e projektit "Shqipëria drejt gjuhës efektive të shenjave.

Shqipëria

Republika e Shqipërisë me vendim të Këshillit të Ministrave nr.837 të datës 3.12 2014 njohu gjuhën e shenjave. Ky vendim u bazua në mbështetje të neneve 18 e 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 4, 5, 9, 13, 21, 24 e 30, të Konventës së Kombeve të Bashkuara "Për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara", ratifikuar me ligjin nr.108/2012. Në këtë shtet, mungojnë mekanizmat për ofrimin e shërbimeve të gjuhës së shenjave[32].

Bazuar në Censusin e Popullsisë dhe Banesave të INSTAT 2011, në Shqipëri numërohen 39.000 persona që nuk dëgjojnë. Komuniteti i njerëzve që nuk dëgjojnë në Shqipëri përballet me vështirësi në pjesëmarrjen e plotë në shoqëri për shkak të barrierave të shumta. Pavarësisht progresit që vendi ka bërë në fushën e aftësisë së kufizuar duke ratifikuar Konventën e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDPAK) në shkurt 2013, njohjen e gjuhës së shenjave shqipe në vitin 2014, dhe akteve të tjera nënligjore lidhur me të drejtat e personave që nuk dëgjojnë, pak progres është bërë në praktikë në lidhje me situatën e personave me aftësi të kufizuara, veçanërisht të personave që nuk dëgjojnë lidhur me aksesin në shërbime interpretimi në institucionet publike.

Maqedonia e Veriut

Gjuha maqedonase e shenjave është gjuha e shenjave e komunitetit të shurdhërve në Maqedoninë e Veriut. Gjuha maqedonase e shenjave është e rregulluar me ligj kombëtar të datës 21 gusht 2009. Ky ligj rregullon

---

[31] https://wfdeaf.org/news/the-legal-recognition-of-national-sign-languages/ , qasur me 08.11.2024

[32] Sstudim mbi praktikat me te mira per ofrimin e sherbimeve te interpretimit te gjuhes se shenjave ne Balkan dhe Evrope, ANAD dhe USAID, Maj 2023, faqe 15

të drejtën e përdorimit të gjuhës së shenjave, te drejtat e personave që nuk dëgjojnë dhe me vështirësi në dëgjim, gjuhën e shenjave, mësimi i gjuhës së shenjave, interpretët e gjuhës së shenjave.[33]

Në nivel shtetëror të Maqedonisë se Veriut, ekziston një listë me 34 interpret. Televizionet kombëtare të lajmeve interpretohen në gjuhën maqedonase. Qeveria miraton një program vjetor për rimbursimin e mjeteve të paguara si doganë, tatimin mbi vlerën e arritur dhe akcize për personat të verbër me shoqërues dhe për anëtarët e personave që nuk dëgjojnë.

Serbia

Kuvendi i Republikës së Serbisë më 28 prill 2015 miratoi "*Ligjin për përdorimin e gjuhës së shenjave*". Ky ligj rregullon përdorimin e gjuhës së shenjave, të drejtën për të mësuar gjuhën e shenjave edhe të drejtën e përdorimit të shërbimit të përkthimit të gjuhës së shenjave, mënyrën e përdorimit të shenjës shërbime të përkthimit të gjuhës, stimuj për aplikimin dhe përmirësimin e gjuhës së shenjave përdorin duke informuar dhe edukuar në gjuhën e shenjave dhe çështje të tjera të rëndësishme për përdorimin e gjuhës së shenjave.

Në Serbi, ndër të tjera, personi që nuk dëgjon nga neni 6 paragrafi 1 i Ligjit për përdorimin e gjuhës së shenjave do të realizojë shërbimin e interpretimit të gjuhës së shenjave në bazë të kërkesës së paraqitur më parë shoqatës së personave me aftësi të kufizuara në komunën apo njësisë së vetëqeverisjes vendore ku banon. Përdoruesit e gjuhës së shenjave në Serbi përmes Skype çdo ditë nga ora 7 deri në 19:00 ofrojnë shërbime për interpretim. Po ashtu, në bazë të Ligjit për përdorimin e gjuhës së shenjave, financat sigurohen në kuadër të mjeteve të parapara nga Buxheti i Republikës së Serbisë, financimi i organizatave të personave me aftësi të kufizuara dhe shoqatave të ngjashme objektivi i të cilave është përmirësimi i pozitës socio-ekonomike dhe sociale të personave me aftësi të kufizuara, të shpërndara nga Ministria sipas mundësive, d.m.th brenda mjeteve në dispozicion të destinuara për financimin e institucioneve të mirëqenies sociale ose ofrues të tjerë të mirëqenies sociale, sipas mundësive; brenda aseteve të njësive komunale të destinuara për zhvillimin e mirëqenies sociale.

Bosnja dhe Hercegovina

Bosnia dhe Hercegovina e ka njohur gjuhën e shenjave me ligj në vitin 2009. Ky ligj rregullon të drejtën e personave të Shurdhër për të përdorur gjuhën e shenjave në Bosnje dhe Hercegovinë dhe të drejtën e personave për informacion nëpërmjet teknikave të përshtatura për nevojat e tyre, si dhe vëllimin dhe metodën për të ushtruar të drejtën për një interpret të gjuhës së shenjave, me qëllim të përfshirjes së tyre të barabartë në mjedisin e jetesës dhe të punës, si dhe në të gjitha format e jetës shoqërore me të drejta dhe kushte të barabarta, si dhe mundësi të barabarta të personave pa dëmtim të dëgjimit.

Në Bosnjë dhe Hercegovinë rreth 0.5% e popullsisë janë përdorues të Gjuhës së Shenjave. Përkatësisht, rreth 20000 qytetarë të Bosnjës dhe Hercegovinës janë përdorues të kësaj gjuhe. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, Gjuha e Shenjave njihet si gjuhë zyrtare. Bosnja dhe Hercegovina zyrtarizmin gjuhës se shenjave e ka bërë në vitin 2009. Po ashtu, në këtë shtet funksionon edhe Asociacioni i Njerëzve që Nuk Dëgjojnë dhe Personave me Vështirësi në Dëgjim. Asociacion ka bërë përpjekje të konsiderueshme që në vitin 2009 të miratohet Ligji për Përdorimin e Gjuhës së Shenjave në Bosnje dhe Hercegovinë, përmes të

[33] Po aty, faqe 40

cilit gjuha e shenjave njihet si gjuhë zyrtare. Në korrik të vitit 2017, Bosnja dhe Hercegovina ka miratuar Strategjinë për Avancimin e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara në Bosnje dhe Hercegovinë (2016 – 2021).

Finlanda

Në Finlandë ka rreth 8000 persona që nuk dëgjojnë, 5000 prej të cilëve përdorin gjuhën e shenjave si gjuhë të parë. Është vlerësuar se numri i përdoruesve të gjuhës së shenjave në këtë shtet arrin në rreth 15 mijë. Guri i themelit të gjuhës finlandeze të shenjave u vendos në vitin 1995, kur seksioni për gjuhën të drejtat e dispozitave të ndryshuara të Kushtetutës finlandeze ofronte mbrojtje për përdoruesit e gjuhës së shenjave. Po ashtu, Finlanda është një nga vendet e para në botë që ka miratuar gjuhën e shenjave në kushtetutën e saj (1995). Akti i Kushtetutës së Finlandës (731/1999) u rinovua në vitin 1999 dhe përmban klauzolën e përgjithshme kundër diskriminimit në seksionin 6. Klauzola kundër diskriminimit rregullon që pa arsye të pranueshme, askush nuk duhet të vendoset në një pozicion të ndryshëm për shkak të, p.sh., gjuhës dhe paaftësisë.

Në Finlandë, sipas Ligjit mbi Shërbimet dhe Ndihmën për Personat me Aftësi të Kufizuara (380/1987), neni 8, Komuna do të sigurojë personat me aftësi të kufizuara të rënda me shërbime të arsyeshme përkthimi dhe shërbime strehimi nëse, për shkak të paaftësisë ose sëmundjes së tyre, kanë nevojë për ndihmë për të menaxhuar punët e tyre të përditshme. Finlanda i ka kushtuar rendësi të madhe ngritjes së kapaciteteve dhe trajnimeve të profesionisteve dhe për këtë ka zhvilluar një program trajnimi për mësuesit e klasave të përdoruesve të gjuhës finlandeze të shenjave i cili filloi në vjeshtën e vitit 1998, ku 10 studentë filluan studimet e tyre.

Sllovenia

në vitin 2002, Sllovenia miratoi Ligjin për përdorimin e gjuhës sllovene të shenjave, i cili njeh të drejtën e personave që nuk dëgjojnë për të përdorur Gjuhën e Shenjave Sllovene dhe të drejtën për një interpret të gjuhës së shenjave. Ligji u jep qytetarëve që nuk dëgjojnë të drejtën për të përdorur gjuhën e tyre, gjuhën sllovene të shenjave dhe të drejtën për t'u informuar me teknika të përshtatura. Për më tepër, në Sllloveni u sigurohet qytetarëve që nuk dëgjojnë të drejtën e një interpreti të gjuhës së shenjave kur kanë të bëjnë me autoritetet, 30 orë shtesë përkthimi për situata sipas gjykimit të tyre dhe gjithsej 100 orë përkthim në vit për arsye edukative për ata që kanë statusin e nxënësit apo studentit. Ka rreth 6,000 individë të që nuk dëgjojnë dhe me dëgjim të pjesshëm në Republikën e Sllovenisë, për të cilën komunikimi është ose i vështirë ose i pamundur. Ato përfshijnë 2500 persona që nuk dëgjojnë, të cilët përdorin kryesisht gjuhën sllovene të shenjave. Gjithashtu, në Sllloveni regjistri i interpretëve të gjuhës së shenjave mbahet nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen e aftësisë së kufizuar dhe përmban: datën dhe numrin e vendimit për regjistrim në regjistër, të dhënat personale (emri dhe mbiemri i interpretit, data dhe vendi i lindjes, niveli dhe fusha e arsimit të arritur, vendbanimi, numri tatimor), -datën dhe numrin e lëshimit të certifikatës, si dhe kualifikim profesional të fituar. Për ndihmë profesionale në vendimmarrje dhe në përgatitjen e rregulloreve dhe akteve tjera ligjore, **Qeveria e Republikës së Slloveniseë themelon Këshillin për gjuhën sllovene të shenjave.**

Mungesa e një baze ligjore të qartë për gjuhën e shenjave në Kosovë është një problem themelor për komunitetin e të shurdhërve. Pa një ligj specifik që rregullon dhe përcakton shërbimet në gjuhën e shenjave, ata ballafaqohen me pengesa të mëdha në qasjen e tyre në shërbimet publike dhe private, si dhe në institucionet shoqërore dhe arsimore. Në këtë aspekt mungesa e ligjit, dërgon edhe në situata të ndryshme

diskriminuese për këtë kategori të personave në përgjithësi, në krahasim me kategoritë e tjera të cilat në Republikën e Kosovës janë të rregulluara me ligj, siç janë të verbrit.

Ukraina

Në Ukrainë, gjuha e shenjave u njoh si pjesë e legjislacionit për aftësinë e kufizuar. Shoqata Ukrainase e të Shurdhërve ka mbrojtur që një projekt-ligj i veçantë për gjuhën e shenjave ukrainase të miratohet nga qeveria me objektivin që të ketë mbrojtje më të fortë për të drejtat e gjuhës së shenjave në fusha të ndryshme të jetës, si qasja në kujdesin shëndetësor, arsimin dhe profesional interpretimi i gjuhës ukrainase të shenjave. Ishte e qartë se komuniteti i shurdhër i Ukrainës nuk kishte besim se të drejtat e tyre brenda kornizës së gjuhës së shenjave mbroheshin dhe mbështeteshin mjaftueshëm nga legjislacioni i përgjithshëm i aftësisë së kufizuar. Në fund të vitit 2018, projektligji po paraqitej në Parlamentin e Ukrainës.[34] Komisioni i Venecias dha një opinion lidhur me Ligjin për Mbështetjen e funksionimit të Gjuhës Ukrainase si Gjuhë e Shtetit dhe në kuadër të këtij drafti, respektivisht në nenin 4 kishte njohur statusin e gjuhës së shenjave në Ukrainë. Statusi i kësaj gjuhe ishte njohur si gjuhë e personave të gjuhës së shenjave. Po ashtu, të gjithë personave i ishte garantuar përdorimi i gjuhës se shenjave në jetën publike, përfshirë edhe studime në gjuhën e shenjave.[35]

Si rezultat i atyre që u thanë më sipër, mungesa e ligjit për gjuhën e shenjave sjell një varg problemesh, të cilat mund ti përmbledhim si në vijim:

- Efekti domino dhe pamundësimi i personave të shurdhër që të qasen në jetën sociale, në marrjen e shërbimeve adekuate si dhe izolimi social;
- Mungesa e edukimit bazik;
- Zhvillimi i personave të shurdhër, në mungesë të gjuhës së shenjave;
- Pa një ligj të posaçëm për këtë çështje, nuk ka udhëzime të qarta se si duhet të jenë organizuar dhe siguruara shërbimet në gjuhën e shenjave për qytetarët e Kosovës;
- Mungesa e baze ligjore për shërbime të gjuhës së shenjave në sektorin privat. Sektori privat, përfshirë noterët, bankat, spitale private, dhe shumë të tjera, nuk kanë një kornizë ligjore të qartë që t'u lejojë të ofrojnë shërbime në gjuhën e shenjave;
- Mungesa e detyrimit ligjor për interpretim dhe qasje të barabartë. Nuk ka ligj që detyron institucionet dhe organizatat publike të sigurojnë interpretim të gjuhës së shenjave dhe qasje të barabartë për personat e shurdhër në të gjitha fushat e jetës;
- Mungesa e mbrojtjes së të drejtave dhe trashëgimisë kulturore për personat e shurdhër. Pa një ligj të veçantë që mbrojnë dhe promovojë të drejtat dhe trashëgiminë kulturore të komunitetit të shurdhër në shoqëri, ata janë të prekshëm nga diskriminimi dhe izolimi;
- Situatat e mundshme diskriminuese. Mungesa e një ligji të qartë për gjuhën e shenjave, i sjell në një situatë diskriminuese dhe të pabarabartë në rendin ligjor të Kosovës, personat e shurdhër;
- Mungesa e ligjit për gjuhën e shenjave, sjell një situatë dalluese me kategoritë e tjera, siç janë personat e verbër;

---

[34] Eeva Tupi, SIGN LANGUAGE RIGHTS IN THE FRAMEWORK OF THE COUNCIL OF EUROPE AND ITS MEMBER STATES Publication of the Ministry for Foreign Affairs of Finland 2019, f.26

[35] Opinion No. 960 / 2019 CDL-REF(2019)036 Or. Engl. EUROPEAN COMMISSION FOR DEMOCRACY THROUGH LAW (VENICE COMMISSION) UKRAINE LAW (*) ON SUPPORTING THE FUNCTIONING OF THE UKRAINIAN LANGUAGE AS THE STATE LANGUAGE, f.4.

- Politikat dhe veprimet e institucioneve jo efektive. Mungesa e bazës ligjore të qartë dhe një ligji efektiv, e pamundëson veprimin institucional dhe krijimin e mekanizmave efikas të cilat shërbejnë për arsimin dhe zhvillimin e jetës së personave të shurdhër.

Efektet e kësaj mungese janë të ndjeshme në të gjitha sferat e jetës së personave të shurdhër. Në arsim, ata ndeshen me vështirësi në qasje. Në punë, përballen me diskriminim dhe pengesa në punësim dhe avancim në karrierë. Në shoqëri, ndihen të izoluar dhe të përjashtuar për shkak të barrierave komunikuese dhe mungesës së qasjes së barabartë në informacion dhe shërbime. Po ashtu, nuk mund ti pranojnë në mënyrë efikase shërbimet shëndetësore.

Pema e problemit

Gjuha e shenjave përbën një kategori të rëndësishme për personat e shurdhër, e cila ndihmon ata/ato që të jenë prezent dhe të kenë një arsim efikas, qasje në shërbimet shëndetësore, qasje në shërbime sociale, qasje në institucione publike etj.

Mungesa e një rregullative ligjore më gjithëpërfshirëse dhe më të avancuar lidhur me gjuhën e shenjave në Kosovë, me theks të veçantë nivel të ligjit, i pengon personave të shurdhër që të mos i ekspozohen situatave diskriminuese, respektivisht situatave kur personat e këtij komuniteti janë të privuar nga qasja në arsim, media, institucione publike, si dhe marrjen e shërbimeve në mënyrë efikase dhe jo diskriminuese, përmes një gjuhe të shenjave të njohur si kategori ligjore përmes Ligjit për Gjuhën e Shenjave.

Një ligj për Gjuhën e Shenjave do të ndihmonte në efektet konkrete të personave të shurdhër si dhe vendosjen e standardeve, për të përmirësuar gjenjen e personave të shurdhër, në arsim, shëndetësi, media, punësim dhe çështje sociale etj.

Figura 3: Pema e problemit, që paraqet problemin kryesor, shkaqet e tij dhe efektet

Efektet	Efektet e kësaj mungese janë të ndjeshme në të gjitha sferat e jetës së personave të shurdhër. • Në arsim, mungesa e një bazë ligjore për gjuhën e shenjave pengon qasjen e tyre në edukim elementar arsim cilësor në gjuhën e tyre amtare. • Në punë, personat e shurdhër mund të përballen me diskriminim dhe pengesa në punësim dhe avancim në karrierë për shkak të mungesës së shërbimeve në gjuhën e shenjave. • Në shërbimet publike personat e shurdhër mund të ndihen të diskriminuar për shkak të qasjes në shërbime, në mungesë të gjuhës së shenjave. Shpesh herë në kuadër të ofrimit të shërbimeve mjekësore për shembull, mungesa e interpretëve dhe ofrimi i shërbimeve për gjuhën e shenjave në institucione shëndetësore, ka përkeqësuar edhe më shumë gjendjen e pacientëve të shurdhër. Andaj është shumë e rëndësishme që të ketë sa më shumë shërbime publike, përmes gjuhës së shenjave. • Në shoqëri, personat e shurdhër mund të ndihen të izoluar dhe të përjashtuar për shkak të barrierave komunikuese dhe mungesës së qasjes së barabartë në informacion dhe shërbime; • Efekti domino i izolimit të përsonave të shurdhër, respektivisht izolimin social;

	• Mungesë të theksuar të marrjes së shërbimeve shëndetësore, në mungesë të gjuhës së shenjave; • Në mungesë të mekanizmave efikas, personat e shurdhër mund të ndjehen të përjashtuar në rrethin social dhe familjar; • Mungesa e ligjit për gjuhën e shenjave pamundëson njohje më të gjëre shtetërore të gjuhës së shenjave. • Mungesa e ligjit ka për efekt edhe pamundësinë për përmirësim të infrastrukturës teknologjike për komunikim me gjuhën e shenjave; • Mungesa e ligjit pamundëson edhe zhvillimin e kurrikulave në gjuhën e shenjave me qëllim të integrimit të personave të shurdhër në sistemin e arsimit.
Problemi kryesor	Problemi kryesor është mungesa e një baze ligjore të qartë për gjuhën e shenjave, e cila krijon barriera për të shurdhrit në arsim, punësim, shërbime shëndetësore dhe komunikim efektiv.
Shkaqet	Shkaqet përfshijnë: 1. Mungesë e politikave efikase që adresojnë të gjitha problemet për personat e shurdhër; 2. Mungesë e politikave proaktive që qojnë në konsolidimin e bazës ligjore për personat e shurdhër dhe gjuhën e shenjave; 3. Mungesë e zbatimit efektiv të dokumenteve strategjike dhe dokumenteve tjera për gjuhën e shenjave për shkak të mos zbatimit nga të gjitha institucionet; 4. Neglizhencë e theksuar e institucioneve politikbërëse, në zbatimin e zotimeve, përsa i takon përmirësimit të gjendjes në gjuhën e shenjave; 5. Mosndarja e buxhetit për zbatimin e rregullave dhe politikave aktuale në fuqi për gjuhën e shenjave; 6. Mungesa e vullnetit për ta zbatuar politikat ekzistuese dhe një qasje burokratike, në disa aspekte.

Figura 4:

Pasqyrë e palëve të interesuara bazuar në përkufizimin e problemit

Emri i palës së interesuar	**Shkaku-qet me të cilat është e lidhur pala**	**Efekti-et me të cilat është e lidhur pala**	**Mënyra me të cilën pala është e lidhur me këtë shkak (shkaqe) apo efektin (efektet)**
Shoqata Kosovare e të Shurdhërve	Kjo shoqatë ka qenë avokuese e vazhdueshme në përmirësimin e	Përfshirja e palës përkatëse do të ndihmonte në hartimin e koncept dokumentit për gjuhën e shenjave për	Përgjegjësi avokuese dhe politikbërëse për personat e shurdhër dhe zgjidhjen e sfidave të tyre.

	gjendjes së personave të shurdhër në Kosovë	shkak të përvojës të lartë dhe ekspertizës së vazhdueshme përkitazi me kategorinë e personave të shurdhër në Republikën e Kosovës.	
Zyra për Qeverisje të Mirë/ZQM	Detyrat e përcaktuara me rregulloret përkatëse në fuqi lidhur me personat e shurdhër	Përfshirja e palës në hartimin e koncept dokumentit duke pasur parasysh kompetencat e saj ligjore, në fushën e personave me aftësi të kufizuara	Përgjegjësi politikëbërëse dhe zbatuese.
Ministria e Arsimit, e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit-MASHTI	Detyrat e përcaktuara me Ligjin për Arsimin Parauniversitar lidhur me gjuhën e shenjave në shkolla	Përfshirja e palës në hartimin e këtij koncept dokumenti dhe opsionit të propozuar	Përgjegjësi zbatuese të ligjit dhe politikave përkatëse
Ministria e Shëndetësisë-MSH	Ministria e Shëndetësisë dhe organet e tjera të ndërvarura përcaktojnë politika përkatëse të ofrimit të shërbimeve shëndetësore.	Përfshirja e Ministrisë së Shëndetësisë lidhet me faktin që personat e shurdhër kanë nevojë për qasje në institucione shëndetësore dhe në ofrimin e shërbimeve përkatëse shëndetësore për ta.	Përgjegjësi zbatuese
Këshilli i Personave me aftës të kufizuar	Përcakton dhe formulon rekomandime për personat e shurdhër	Personat e shurdhër në kuptimin e politik bërjes lidhen me Këshillin e Personave me aftësi të kufizuar	Përgjegjësi për bërje të politikave dhe formulimin e tyre.
Grupet e synuara/të gjithë personat e shurdhër në Republikën e Kosovës	Opsioni i propozuar i dedikohet këtyre grupeve	Mungesa e shërbimeve të gjuhës së shenjave, mungesa e mbrojtjes ligjore, mungesa e të drejtave elementare të këtyre personave	Për shkak se opsioni 3 si opsion i propozuar ndërlidhet me këto palë.

Kapitulli 2: Objektivat

Ligji për gjuhën e shenjave përmes këtij koncept dokumenti synon të përmbushë disa objektiva të rëndësishme, përmes të cilave përmirëson gjendjen dhe zbaton opsionin e zgjedhur. Objektivat e paraqitura

janë të mbështetura në dokumente relevante dhe të miratuara, të cilat ndërlidhen me koncept dokumentin dhe materien e ligjit për gjuhën e shenjave. Objektivat e paraqitura nuk kanë qenë të parapara ndonjëherë si të tilla dhe të njëjtat ndërlidhen edhe me nevojën e ekzistimit të ligjit për gjuhën e shenjave.

Figure 5: Objektivat relevante të Qeverisë

Objektivi relevant	**Emri i dokumentit përkatës të planifikimit (burimi)**
Sigurimi i mjediseve shkollore të shëndetshme, të sigurta dhe të përshtatshme sipas nor mave dhe standardeve, që mundësojnë mësim cilësor (Objektiv specifik)	Strategjia e Arsimit 2022-2026
Rritja e përfshirjes dhe pjesëmarrjes aktive të nxënësve nga grupet e margjinalizuara përmes krijimit të klimës nxitëse dhe përkrahëse (Objektiv Specifik)	Strategjia e Arsimit 2022-2026
Sigurimi i mundësive për realizimin e mësimit praktik dhe funksionalizimi i shërbimeve të këshillimit në karrierë (Objektiv Specifik)	Strategjia e Arsimit 2022-2026
Sigurimi i infrastrukturës shkollore për nxënësit me aftësi të kufizuara (të shurdhër)	Strategjia e Arsimit 2022-2026
Fuqizimi i politikave dhe legjislacionit kundër diskriminimit (Objektiv Specifik)	Plani Kombëtar për Zhvillim 2024-2026
Objektivi strategjik 1. Përmirësimi i cilësisë në shërbime sociale për persona me aftësi të kufizuar	PLANI I VEPRIMIT PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR 2025-2027
Objektivi specifik I.1 Përmirësimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse sociale për personat me aftësi të kufizuar	PLANI I VEPRIMIT PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR 2025-2027
Objektivi strategjik 2. Avancimi i sistemit gjithëpërfshirës në arsimim dhe ngritjen profesionale të personave me aftësi të kufizuar	PLANI I VEPRIMIT PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR 2025-2027
Objektivi strategjik .3. Përmirësimi i qasjes për persona me aftësi të kufizuar	PLANI I VEPRIMIT PËR TË DREJTAT E PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUAR 2025-2027
Objektivi specifik I.1 Përmirësimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse sociale për personat me aftësi të kufizuar	Plani i Veprimit për te Drejtat e Personave me Aftësi te Kufizuar 2025-2027
Objektivi specifik I.2: Krijimi i mekanizmave për monitorimin e politikave për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar	Plani i Veprimit për te Drejtat e Personave me Aftësi te Kufizuar 2025-2027
Objektivi specifik II.2: Ngritja e kapaciteteve të stafit mbështetës për personat me aftësi të kufizuar si dhe personave me aftësi te kufzuar	Plani i Veprimit për te Drejtat e Personave me Aftësi te Kufizuar 2025-2027

Ngritja e pjesëmarrjes dhe aktivizimit të nxënësve me aftësi të kufizuar (personat e shurdhër)

Kjo objektive me zgjedhjen e njërit nga opsionet, sidomos opsionit të rekomanduar do të ndihmonte në ngritjen e pjesëmarrjes dhe aktivizimit të nxënësve, në pjesën e arsimit, sidomos në kuadër të qendrave të caktuara burimore, në sistemin arsimor. Kjo do të mundësonte përfshirjen sa më të madhe të personave të shurdhër në sistemin arsimor.

Sigurimi i infrastrukturës shkollore për nxënësit me aftësi të kufizuara (personat shurdhër)

Kjo përbën një objektivë e cila do të ndihmojë me jetësimin e këtij koncept dokumenti. Nxjerrja e ligjit ose forcimi i infrastrukturës ligjore edhe më tutje, do të mundësonte dhe obligonte shtetin, në kryerjen e sa më shumë veprimeve që ndihmojnë infrastrukturën shkollore, për nxënësit e kategorisë së personave të shurdhër.

Fuqizimi i politikave dhe i legjislacionit kundër diskriminimit

Kjo objektivë nënkupton fuqizimin e legjislacionit kundër diskriminimit, që në rastin konkret në mënyrë indirekt mund ti prek edhe personat e shurdhër.

Hartimi i Koncept Dokumentit për Gjuhën e Shenjave

Kjo objektivë lidhet drejtpërdrejtë me aktivitetin e hartimit të një koncept dokumenti, i cili mbështet opsionin më të pranueshëm, të hartimit të një ligji për gjuhën e shenjave.

Integrimi i të drejtave dhe nevojave te personave me aftësi të kufizuar në të gjitha aspektet e qeverisjes, politikave dhe shërbimeve të Kosovës

Në kuptimin e gjerë, personat e shurdhër cilësohen si perona me aftësi të kufizuara dhe integrimi i të drejtave të personave me aftësi të kufizuara, nënkupton ndër të tjera edhe adresimin dhe gjetjen e zgjidhjes adekuate edhe për çështjen e të shurdhërve.

Krijimi i një kornize gjithëpërfshirëse të bazuar në të drejta dhe politikave përfshirëse që integron çështjet e aftësisë së kufizuar në politikat dhe planet sektoriale përkatëse

Kjo nënkupton krijimin e një politike gjithëpërfshirëse, për mbrojtjen e personave me aftësi të kufizuara. Kjo në rastin konkret lidhet me avancimin e pozitës së peronave të shurdhër përmes hartimit të ligjit për gjuhën e shenjave.

Kapitulli 3: Opsionet

Grupi Punues për hartimin e Koncept Dokumentit për gjuhën e shenjave ka shqyrtuar tri opsione kryesore për adresimin e çështjeve që lidhen me zbatimin e shërbimeve të gjuhës së shenjave në Republikën e Kosovës.

Dy opsionet e para të shqyrtuara, pra opsioni për asnjë ndryshimi dhe opsioni i përmirësimit të legjislacionit (pa bazë ligjore për ndryshim), u konkluduan që nuk janë të mjaftueshme për adresimin e problemeve të identifikuara në këtë Koncept Dokument.

Opsioni i vetëm që adreson problemet e identifikuara është opsioni i tretë - është opsioni i hartimit të **Ligjit për Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës.**

Sipas opsionit të parë, nuk ka nevojë për asnjë ndryshim dhe se ruhet gjendja ekzistuese, sidomos e infrastrukturës ligjore. Në anën tjetër, opsioni i dytë nënkupton një kombinim, që nënkupton zbatimin e ekzekutimit, por megjithatë nuk mund të garantojë një përparim të plotë përsa i takon gjuhës së shenjave.

Kapitulli 3.1: Opsioni 1 ose opsioni pa asnjë ndryshim

Opsioni pa asnjë ndryshimi në legjislacionin ekzistues, mund të sjellë si rezultat që situata aktuale për personat të shurdhër mund të vazhdojë pa ndonjë ndryshim të rëndësishëm. Kjo do të thotë se mungesa e një bazë ligjore specifike për gjuhën e shenjave do të mbetet e pandryshuar, duke i lënë personat e shurdhër në një situatë të vështirë. Janë disa efekte që do të rezultonin, në rast të zgjedhjes së këtij opisioni dhe atë si në vijim:

Mungesa e qartësisë ligjore: Pa një ligj specifik për gjuhën e shenjave, nuk do të ketë udhëzime të qarta dhe detyrime për institucionet dhe organizatat për të siguruar qasje të barabartë për personat e shurdhër.

Pengesat në qasje në shërbime: Institucionet publike dhe private, si dhe organizatat përkatëse përfshirë dhe ato arsimore, do të vazhdojnë të mos ofrojnë shërbime të përshtatura për personat që nuk dëgjojnë, duke i i bërë ata në vështirësi për të komunikuar dhe për të përdorur shërbimet.

Diskriminimi dhe izolimi: Mungesa e një baze ligjore të qartë për gjuhën e shenjave mund të çojë në diskriminim dhe izolim për personat e shurdhër, të cilët mund të ndihen të përjashtuar nga shoqëria për shkak të barrierave komunikuese.

Në këtë mënyrë, Opsioni 1 mund të rezultojë në vazhdimin e situatës së vështirë për personat e shurdhër, duke i lënë ata në një pozitë të pazhvilluar dhe të kufizuar pjesëmarrjen në shoqëri.

Ky opsion si i tillë nuk mundëson asnjë ndryshim faktik dhe në kuadrin ligjor. Një mungesë e ligjit do të krijonte pengesa reale për: diskriminim të personave të shurdhër, sepse nuk ka mekanizma të mjaftueshëm për ti mbrojtur; Mungesë të ofrimit të shërbimeve, sepse ligji do të krijonte mundësi më të mëdha për shërbime efikase; Mungesë të qasjes në institucione, sepse ligji do të mundësonte që në mënyrë obligative personat e shurdhër të kishin qasje në institucione dhe shërbime; Mungesë e infrastrukturës teknologjike. Mungesa e ligjit do të mundësonte që të kishte një strategji më të avancuar.

Avantazhet e këtij opsioni janë: kursimi i buxhetit dhe resurseve. Disavantazhet e këtij opsioni janë të shumta sepse nuk krijojnë mundësi reale dhe mekanizma të cilat fuqizojnë dhe mundësojnë: luftimin e diskriminimit për personat e shurdhër, qasjen në shoqëri dhe institucione, kufizimin në qasjen në shërbimet publike etj.

Kapitulli 3.2: Opsioni për përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit

Nëse nuk ka një bazë ligjore specifike për ndryshimin e legjislacionit në lidhje me gjuhën e shenjave, ndryshimi i legjislacionit aktual mund të ketë vështirësi të cilat mund të përshkallëzohen. Kjo mund të shkaktojë zvarritje të procesit të ndryshimit ligjor dhe vonesa në hartimin dhe zbatimin e politikave dhe masave të reja për komunitetin e shurdhër.

Mungesa e një bazë ligjore specifike: Pa një bazë ligjore të qartë dhe specifike për ndryshimin e legjislacionit në lidhje me gjuhën e shenjave, procesi i ndryshimit mund të ketë mungesë të udhëzimeve dhe kriteret e nevojshme për të hartuar politikat dhe masat e duhura.

Vështirësi në zbatimin e ndryshimeve: Pa një bazë ligjore të qartë, institucionet mund të kenë vështirësi në zbatimin e ndryshimeve të legjislacionit dhe në kuptimin e detyrimeve të tyre në lidhje me gjuhën e shenjave.

Zvarritje e procesit ligjor: Mungesa e një bazë ligjore të qartë për ndryshimin e legjislacionit mund të shkaktojë zvarritje të procesit ligjor, duke shtyrë më tej hartimin dhe zbatimin e politikave dhe masave të nevojshme për personat që nuk dëgjojnë.

Vonesa në garantimin e të drejtave: Pa një bazë ligjore të qartë, personat që nuk dëgjojnë mund të përballen me vonesa në garantimin e të drejtave të tyre për qasje të barabartë në shërbimet publike dhe private, si dhe në institucionet shoqërore dhe arsimore.

Mos efikasitet në kryerjen e shërbimeve: Me një bazë ligjore aktuale, pavarësisht vullnetit për të bërë ndryshime dhe për të rritur efektin në ekzekutim, do të jetë e pamundur krijimin e qasjes në shërbime për persona të shurdhër. Po ashtu, baza ligjore aktuale nuk do të mundësonte që të kishte një efikasitet në kryerjen e shërbimeve për personat e shurdhër.

Pamundësia për të avancuar më tutje politikat aktuale: Në rast se zbatohet opsioni 2, kjo do të pamundësojë që të avancohen më tutje politikat dhe aktet nënligjore, për shkak të mungesës së bazës konkrete ligjore. Pa një bazë konkrete ligjore nuk mund të nxjerrën udhëzime të reja. Qeveria e Replikës së Kosovës ka shfuqizuar aktet nënligjore që nuk kanë pasur bazë konkrete ligjore, përmes projektit Gijotina.[36]

Këto sfida dhe vështirësi mund të krijojnë një klimë të pasigurte dhe të vështirë për personat e shurdhër, duke i lënë ata në një situatë ku pengesat për qasje të barabartë vazhdojnë të ekzistojnë. Opsioni për 'përmirësimin e zbatimit dhe ekzekutimit' është një opsion që duhet të merret parasysh në çdo Koncept Dokument në përputhje me Udhëzuesin për Hartimin e Koncept Dokumenteve. Megjithatë në rastin konkret, në kuptim të gjendjes së personave të shurdhër në Republikën e Kosovës, ky opsion nuk mund të zgjidhte problemin.

Avantazhet e këtij opsioni janë: kursimi i buxhetit dhe resurseve apo barra më e vogël administrative. Disavantazhet e këtij opsioni janë të shumta sepse nuk krijojnë mundësi reale dhe mekanizma të cilat fuqizojnë dhe mundësojnë: luftimin e diskriminimit për personat e shurdhër, qasjen në shoqëri dhe institucione etj. Disavantazhet janë po ashtu të njëjta, sikurse edhe tek opsioni i parë përfshirë edhe kufizimin në qasjen në shërbimet publike.

Kapitulli 3.3: Opsioni i tretë hartimi i Ligjit për Gjuhën e Shenjave në Republikën e Kosovës

Opsioni i propozuar: Propozohet që të hartohet një ligj specifik për gjuhën e shenjave në Republikën e Kosovës, që do të mbrojë dhe të promovojë të drejtat e personave të shurdhër në lidhje me gjuhën e shenjave, duke siguruar qasje të barabartë në të gjitha fushat e jetës. Ky ligj mendohet që ne vitet ne vijim 2026 dhe 2027 te ketë kosto shtesë e parapare rreth 150000 (njëqind e pesëdhjetë mijë euro) në vitin 2026

[36] Faza e dytë e prioriteteve politike BE – Kosovë: Agjenda për Reforma Evropiane (ERA) II, Tetor 2021 Prishtinë, Qeveria e Republikës së Kosovës, f.16.

si dhe ne vitin2027 100,000 e që i bie diku 150000 (njëqind e pesedhjete mijë) në ndërsa e gjithë kostoja opsionit te rekomanduar nr 3, parashihet te jetë 269.400.00 euro përfshire kategoritë e shpenzimit paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime si dhe mjetet ekzistuese.

Një ligj për gjuhën e shenjave në Republikën e Kosovës, është i pamohueshëm dhe i rëndësishëm për të promovuar të drejtat, dinjitetin dhe përfshirjen e personave të shurdhër në shoqëri. Duke njohur gjuhën e shenjave si një formë legjitime gjuhësore dhe kulturore, një ligj i këtillë vendos themelet për një të ardhme më të drejtë dhe më të qasshme për të gjithë. Ky ligj jo vetëm që siguron qasje të barabartë në shërbime dhe mundësi për përdoruesit e gjuhës së shenjave, por gjithashtu kontribuon në mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë të komunitetit të shurdhër. Nëpërmjet njohjes ligjore, ata bëhen të ndërgjegjshëm për të drejtat e tyre dhe janë në gjendje të përdorin gjuhën e tyre natyrale për të shprehur nevojat dhe shqetësimet e tyre. Kështu, një ligj për gjuhën e shenjave shërben si një instrument jetësor për të siguruar përparim për komunitetin e shurdhër, duke kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse.

Në vitet e fundit, shumë shtete të Bashkimit Evropian dhe të Ballkanit kanë miratuar ligje të tilla, duke filluar një proces të rëndësishëm drejt barazisë dhe inkluzionit.

Mungesa e një ligji të gjuhës së shenjave paraqet një boshllëk juridik, duke bërë që komuniteti i shurdhër të mbetet pa mbrojtje të mjaftueshme dhe të përjashtuar nga shumë aspekte të shoqërisë. Miratimi i ligjit dhe akteve të tjera nënligjore do të krijojë një bazë ligjore të qartë dhe do të ndihmojë në adresimin e kësaj situate.

Me një ligj të gjuhës së shenjave në vend, komuniteti i shurdhër do të mund të ketë qasje të barabartë në shërbimet publike dhe private, duke përfshirë arsimin cilësor dhe qasje në informacion. Ligji do të përcaktojë detyrimet për institucionet dhe organizatat për të siguruar interpretim të gjuhës së shenjave dhe për të garantuar që shërbimet janë të arritshme për të gjithë.

Në të njëjtën kohë, aprovimi i ligjit do të krijojë mundësi për zhvillimin e programeve trajnimi për interpretet e gjuhës së shenjave, duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve të interpretimit dhe duke përmirësuar qasjen e komunitetit të shurdhër në shoqëri. Kjo gjithashtu mund të çojë në rritjen e ndërgjegjësimit dhe respektit për punën e interpretuesve të gjuhës së shenjave, duke i kompensuar ata në mënyra të ndryshme për kontributin e tyre në shoqëri.

Republika e Kosovës përmes miratimit të ligjit për gjuhën e shenjave, do t'i siguronte një trajtim të barabartë personave të shurdhër, duke respektuar parimin kryesor të barazisë paa ligjit, i promovuar në Kushtetutën e Kosovës, në nenin 24.1, i cili ndër të tjera përcakton: "**Të gjithë janë të barabartë para ligjit. Çdokush gëzon të drejtën e mbrojtjes së barabartë ligjore, pa diskriminim**". Mungesa e qasjes në informacion, qasjes në institucione publike, qasjes në shërbime dhe qasjes në arsim e shëndetësi, i bën personat e shurdhër që me automatizëm të ndihen të diskriminuar, në kuptimin e një pozite të pabarabartë juridike dhe për këtë arsye nxjerrja e një ligji për gjuhën e shenjave do të lehtësonte jetim dhe qasjen e personave të shurdhër në çdo pjesë të jetës publike dhe qasjes në shërbime të ndryshme. Mbi të gjitha do të ndalonte edhe diskriminimin. Ky opsion po ashtu do të krijonte një bazë të rëndësishme ligjore, e cila do të lehtësonte qasjen e personave të shurdhër në shërbime publike, duke krijuar dhe forcuar mekanizmat zbatues të opsionit 3, ligjit për Gjuhën e Shenjave.
Disavantazhet e këtij opsioni janë të kundërta me opsionin 1 dhe 2, kurse avantazhet janë të shumta dhe arsyetojnë këtë opsion. Ndër të tjera këto avantazhe janë: baza ligjore më e fortë dhe e qartë; mekanizmat

e mbrojtjes së personave të shurdhër nga diskriminimi; mekanizma efikas në zbatim të gjuhës së shenjave; përmirësim i qasjes së personave të shurdhër; zhvillim i teknologjisë së personave të shurdhër.

Kapitulli 4: Identifikimi dhe vlerësimi i ndikimeve të ardhshme

Tabela më poshtë paraqet ndikimet më të rëndësishme që janë identifikuar. Shtojcat 1 deri 4 paraqesin vlerësimin e të gjitha ndikimeve në përputhje me mjetet për identifikimin e ndikimeve ekonomike, shoqërore, mjedisore dhe ndikimeve të të drejtave themelore. Këto mjete janë të listuara në Manualin për Hartimin e Koncept Dokumenteve. Katër shtojcat gjithashtu tregojnë vlerësimin e rëndësisë së ndikimeve të ndryshme dhe nivelin e preferuar të analizës

Në rastin konkret, do të analizohen ndikimet e ardhme, në aspektet ekonomike, shoqërore, mjedisore dhe lirive dhe të drejtave themelore, bazuar në pritshmëritë e arsyeshme, duke analizuar aspektin e favorizimit të opsionit të mbështetur, respektivisht të pasurit një ligj për gjuhën e shenjave.

Figure 6: Ndikimet më të rëndësishme të identifikuara për kategorinë e ndikimit

Kategoritë e ndikimeve	**Ndikimet përkatëse të identifikuara**
Ndikimet ekonomike	Ligji për gjuhën e shenjave do të promovojë përfshirjen e mëtejshme të personave të shurdhër në tregun e punës, duke ofruar më shumë mundësi për punësim dhe avancim në karrierë. Kjo gjithashtu mund të krijojë treg për shërbime interpretimi të gjuhës së shenjave, duke sjellë investime të reja në këtë fushë. Mundësitë për punësim, duke pasur të rregulluar edhe aspektin ligjor të gjuhës së shenjave do të rezultojnë edhe me një mirëqenie ekonomike të personave të shurdhër. . Ky ligj mendohet që ne vitet ne vijim 2026 dhe 2027 te ketë kosto shtesë e parapare rreth 150000 (njëqind e pesëdhjetë mijë euro) në vitin 2026 50000 euro si dhe ne vitin2027 100,000 e që i bie diku 150000 (njëqind e pesedhjete mijë) në ndërsa e gjithë kostoja opsionit te rekomanduar nr 3, parashihet te jetë 269.400.00 euro përfshire kategoritë e shpenzimit paga dhe mëditje, mallra dhe shërbime si dhe mjetet ekzistuese.
Ndikimet shoqërore	Ligji për gjuhën e shenjave do të promovojë përfshirjen dhe respektimin e komunitetit të shurdhër në shoqëri, duke krijuar një mjedis më të përshtatshëm për ta për të jetuar dhe punuar. Në aspektin e vlerësimit të ndikimeve shoqërore, e rëndësishme është të theksohet që ligji për gjuhën e shenjave do të mundësojë që personat e shurdhër të mos kenë diskriminimin në jetën e tyre, si në punë ashtu edhe në aspektet e tjera.
Ndikimet mjedisore	Nuk ka ndikime direkte, mirëpo me përmirësimin e qasjes në informacion do të ndikojë në kujdesin e shtuar mjedisor nga ana e komunitetit të shurdhërve. Përmasimi i qasjes në informacion do të ketë ndikime indirekt edhe në marrjen e informacioneve të duhura për aspektin mjedisor.
Ndikimet në të drejtat themelore	Ligji për gjuhën e shenjave do të ndikojë në garantimin e të drejtave themelore të personave të shurdhër, përfshirë të drejtën e tyre për qasje në arsim, punë, shërbime shëndetësore dhe informacion. Mbi të gjitha, krijimi i mekanizmave

	si dhe njohja e gjuhës së shenjave, do t'i mundësojë komunitetit si dhe personave të shurdhër qasjen më të lehtë në shoqëri dhe në ofrimin e shërbimeve në mënyrë efikase, pa diskriminim dhe duke obliguar institucionet që përmes veprimeve konkrete, me bazë ligjore, të respektojnë dhe mbrojnë liritë dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuar.
Ndikimi gjinor	Ligji do të ndikojë në barazinë gjinore duke siguruar që gratë dhe burrat e shurdhër të kenë qasje të barabartë në shërbime dhe mundësi të barabarta për zhvillim personal dhe profesional.
Ndikimet e barazisë sociale	Ligji për gjuhën e shenjave mund të ndihmojë në luftën kundër diskriminimit dhe në përmirësimin e barazisë sociale për personat e shurdhër, duke siguruar qasje të barabartë në mundësi dhe shërbime. Gjendja aktuale, pa ligj, siç është thënë, mungesa e ligjit ka sjellë në situata të caktuara personat e shurdhët, që nuk kanë mundur të kenë qasje të lehtë në shërbime dhe në jetën sociale në përgjithësi.
Ndikimet tek të rinjtë	Ligji për gjuhën e shenjave do të ketë ndikime të rëndësishme tek të rinjtë, duke u siguruar mundësi të barabarta për të marrë arsim cilësor dhe për të hyrë në tregun e punës.
Ndikimet në ngarkesën administrative	Përmirësimi i qasjes dhe shërbimeve për personat e shurdhër mund të zvogëlojë ngarkesën administrative për ta dhe për familjet e tyre, duke e bërë jetën e tyre të përditshme më të lehtë. Krijimi i një mekanizmi për interprétët dhe shërbimet e interpretëve gjuhësor do ti mundësojë personave të shurdhër që të lehtësojnë qasjen e tyre në shërbime administrative publike në përgjithësi.
Ndikimi i NMV-ve	Koncept dokumenti sipas këtij opsioni nuk rezulton të ketë ndonjë ndikim negativ në testin e NVM-ve.

Ndikimet sipas Opsionit 1

Ndikimet e opsionit 1 në kuptimin e ndryshimit janë shumë të vogla dhe minore, për shkak se në opsionin përkatës do të vazhdojë të mbetet gjendja e njëjtë, mekanizmat e njëjta, baza ligjore e njëjtë dhe do të vazhdojmë të shfaqen të njëjtat sfida. Pra efektivisht gjendja do të mbetej e pandryshuar. Në kuptimin e ndikimeve opsioni 1 do të vazhdonte gjendjen e njëjtë, duke dhënë mundësi të pakta për progres, përderisa të njëjtat mekanizma, me bazë ligjore të njëjtë do të vazhdojnë të funksionojnë me vështirësi.

Ndikimet sipas Opsionit 2

Ndikimet e opsionit 2 mund të jenë kryesisht minore, për shkak se bëhet fjalë për një opsion, ku baza dhe gjendja juridike nuk ndryshojnë dhe realisht ndryshon vetëm mënyra e zbatimit. Efekti kryesor i këtij opsioni do të ishte qasja proaktive e politik bërësve dhe zbatuesve të saj, të cilët mund të funksionojnë me një intensitet më të shtuar. Megjithatë, nuk mund të pritet ndonjë përmirësim i dukshëm që do të ndryshonte gjendjen e personave të shurdhër. Andaj opsioni i propozuar mbetet opsioni 3.

Ndikimet sipas Opsionit 3

Ndikimet e Ligjit për Gjuhën e Shenjave janë shumë dimensionale dhe se ofrojnë zgjidhje të problemeve në shumë aspekte për personat e shurdhër. Nuk ka dilemë që edhe Kosova, në vetvete duhet të ipmlementojë

standardet ndërkombëtare të Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara. Kjo konventë ka kaluar testin e kushtetushmërisë, sepse në ë këtë aspekt, Republika e Kosovës ka bërë hapa konkret, në nisjen e procesit të amendamentimit të Kushtetutës për të njohur Konventën respektive si një instrument ndërkombëtar dhe për këtë Gjykata Kushtetuese ka nxjërrë, AKTGJYKIM ne rastin nr. K0207/22 Parashtrues Kryetari i Kuvendit te Republikës se Kosovës Konfirmimi i amendamentit te propozuar kushtetues, te paraqitur nga Kryetari i Kuvendit te Republikës se Kosovës me 21 dhjetor 2022, me shkresën nr. 08/3198/DO-1347/1.

Sa më sipër, duhet theksuar se si çdo grup njerëzish që ndajnë një gjuhë të përbashkët ashtu janë njëjtë njerëzit e shurdhër që kanë kulturën dhe gjuhën e tyre. Kjo përfshin besimet, qëndrimet, historinë, normat, vlerat, traditat letrare dhe artin e ndarë nga njerëzit e shurdhër në të njëjtin komunitet ose vend. Ndërsa ndryshon nga vendi në vend, komunitetet e shurdhër ndajnë një gjuhë e një trashëgimi të përbashkët, dhe për këtë arsye identifikohen si anëtarë të një minoriteti kulturor dhe gjuhësor.

Në fakt, **Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara** përcakton se kultura e shurdhërve duhet të njihet dhe të mbështetet si një e drejtë themelore njerëzore. Po ashtu, Federata Botërore e të Shurdhërve identifikon njerëzit e shurdhër si pjesëtarë të një komuniteti kulturor dhe gjuhësor, që përdorin gjuhën e shenjave si gjuhë amtare ose gjuhë natyrore për komunikim[37].

Identiteti i shurdhërve shpesh lidhet me aftësinë për të njohur një gjuhë të shenjave, dhe identifikimi me komunitetin e shurdhërve është një zgjedhje personale. Një komunitet i shurdhërve mund të përfshijë njerëz me shkallë të ndryshme të humbjes së dëgjimit, anëtarë të familjeve të personave të shurdhër, interpretues të gjuhës së shenjave dhe individë që punojnë ose socializohen me persona të shurdhër.

Praktikat më të mira në kuadrin ligjor si dhe mekanizmat institucionalë në Ballkan dhe në disa vende të Bashkimit Evropian, në lidhje me modalitetet e ofrimit të shërbimeve të interpretimit të gjuhës së shenjave në Ballkan dhe Evropë, kryesisht në Kosovë, Maqedoni, Shqipëri, Serbi, Bosnjë dhe Hercegovinë, Greqi, Finlandë, dhe Sllloveni tregojnë për një qasje të përmirësimit të gjuhës së shenjave dhe pozitës së personave të shurdhër.

Në këtë aspekt, një Ligj për Gjuhën e Shenjave do të sillte disa përparësi dhe efekte konkrete për personat e shurdhër sipas seksioneve përkatëse dhe atë si në vijim:

PUNËSIMI

Akomodimet në Punë: Ligji mundëson qasje për të siguruar që ata kanë mundësi të barabarta për punësim dhe për të parandaluar diskriminimin në vendin e punës dhe qasje në interpret çdo herë

ARSIMI

Ndërgjegjësimi dhe Edukimi Publik: Ligji duhet të përfshijë fushata ndërgjegjësimi dhe edukimi për të rritur kuptimin dhe mbështetjen për komunitetin e shurdhër. Kjo ndihmon në krijimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe të barabartë

[37] https://wfdeaf.org/our-work/human-rights-of-the-deaf/ , qasur me 03.11.2024.

Edukimi dhe Trajnimi për staf: Duhet të sigurohet që stafi në institucionet publike dhe private të marrë trajnime të përshtatshme për të kuptuar dhe për t'u marrë me nevojat e personave të shurdhër. Kjo përfshin trajnime për përdorimin e teknologjive të komunikimit dhe për të siguruar një mjedis gjithëpërfshirës.

Testimi dhe Kualifikimi nga Shoqata e të Shurdhërve të Kosovës: Aplikacioni duhet të jetë i testuar dhe kualifikuar nga Shoqata e të Shurdhërve të Kosovës për të siguruar që ai përmbush nevojat funksionale të komunitetit të shurdhër.

Shërbimet e Interpretimit për Personat Non-Verbal apo Mute-Ofrimi i shërbimeve të asistencës dhe komunikimit në kohë reale për personat non-verbal apo mute përmes softuerit të specializuar, që lejon komunikimin efektiv dhe të pavarur.(me interpret nga tekst në të folur dhe anasjelltas).

Studimi mbi Praktikat më të mira për ofrimin e shërbimeve të Interpretimit të gjuhës së shenjave bë Ballkan dhe Evropë i realizuar nga Shoqata Kombëtare Shqiptare e Njerëzve që nuk dëgjojnë (ANAD) me ndihmën e UNDP-së, në Maj të vitit 2023, ndër të tjera vë në dukje disa aspekte të rëndësishme të gjihës së shenjave për personat e shurdhër, duke ofruar statistika konkrete.

QASJA

Qasje në Teknologji: Ligji duhet të promovojë dhe të sigurojë qasje në teknologji të avancuar që ndihmon në komunikimin për personat e shurdhër, siç janë softuerët e interpretimit të gjuhës së shenjave në mënyrë të pavarur ku përdoruesi shtyp numrin e dëshiruar dhe interpreti kyqen në mënyra automatike në bisedë.

Qasja në Uebfaqe: Ligji duhet të kërkojë që të gjitha uebfaqet e institucioneve publike dhe private të jenë të qasshme për personat e shurdhër. Kjo përfshin përdorimin e softuerëve që mundësojnë komunikimin e drejtpërdrejtë nga një uebfaqe tek një call center me interpret të gjuhës së shenjave. Kjo ndihmon personat e shurdhër të kenë qasje të barabartë në informacion dhe shërbime online.

Standardet e qasjes për Aplikacionet dhe Shërbimet Online: Ligji duhet të përcaktojë standarde të qarta për qasjesshmërisë e aplikacioneve dhe shërbimeve online, duke përfshirë funksionalitetin për thirrje pa barriera. Këto standarde duhet të jenë në përputhje me udhëzimet ndërkombëtare për qasjen, siç janë Udhëzimet për Aksesibilitetin e Përmbajtjes së Uebit (WCAG)

Gjuha Shqipe dhe Serverat në Kosovë: Aplikacioni duhet të jetë në gjuhën shqipe dhe të ketë serverat e të dhënave të vendosura brenda territorit të Kosovës për të siguruar mbrojtjen e të dhënave dhe respektimin e ligjeve lokale të privatësisë.

Shërbimet e Interpretimit: Ligji duhet të përfshijë dispozita për shërbimet e interpretimit të gjuhës së shenjave në të gjitha fushat e jetës publike, duke përfshirë gjykatat, institucionet shëndetësore, bankat, dhe sektorin privat. Kjo ndihmon në sigurimin e qasjes të barabartë në shërbime dhe informacione për personat e shurdhër.

Shërbimet e Interpretimit në kohë reale: Ligji duhet të sigurojë që personat e shurdhër të kenë qasje në shërbimet e interpretimit të gjuhës së shenjave në kohë reale, përmes telefonave, uebfaqeve, dhe aplikacioneve mobile. Kjo është e rëndësishme për të siguruar që ata të mund të komunikojnë në mënyrë efektive në çdo situatë. Ofrimi i shërbimeve të asistencës dhe interpretimit në kohë reale për personat me

dobësim të dëgjimit, duke përdorur teknologji të avancuar për të siguruar komunikim të qartë dhe efektiv (me interpret nga tekst në të folur dhe anasjelltas).

Financimi dhe Subvencionimi i Teknologjisë së qasjes: Ligji mund të përfshijë dispozita për financimin dhe subvencionimin e teknologjive të qasjes për personat e shurdhër. Kjo do të ndihmonte në mbulimin e kostove për përdorimin e aplikacioneve dhe pajisjeve ndihmëse.

MBROJTJA


Dispozitat për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Sigurisë: Ligji duhet të sigurojë që aplikacionet dhe teknologjitë e përdorura për komunikimin e personave të shurdhër të kenë masa të forta për mbrojtjen e privatësisë dhe sigurisë. Kjo përfshin mbrojtjen e të dhënave personale dhe komunikimeve.

Integrimi me Numrin Emergjent 112: Aplikacioni Deaf Communication Service duhet të mundësojë thirrjet emergjente dhe komunikimin me numrin emergjent 112 përmes gjuhës së shenjave dhe Real Time Text. Kjo siguron që personat e shurdhër të kenë qasje të barabartë në shërbimet emergjente

Krijimi i një Qendre Kombëtare për Mbështetjen e Teknologjisë së Komunikimit për Personat e Shurdhër: Ligji mund të përfshijë krijimin e një qendre kombëtare që ofron mbështetje dhe trajnime për përdorimin e teknologjive të komunikimit për personat e shurdhër. Kjo qendër mund të ofrojë asistencë teknike dhe edukative për përdorimin e aplikacioneve si Deaf Communication Service.

Në fq.25 ky studim përcakton numrin e orëve të shërbimeve të ofruara për personat e shurdhër në Republikën e Kosovës si në vijim:

Tabela 1: Numri i orëve të shërbimeve të ofruara




[38]

Siç shihet dhe në tabelë gjatë periudhës Janar – Dhjetor 2025 janë ofruar gjithsejtë 5072 orë shërbimi në gjuhën e shenjave. Tani pasja e një ligji për gjuhën e shenjave, do të përmirësonte gjendjen, duke krijuar mekanizmin për çështjen e intepretëve gjuhësor. Në këtë aspekt një mekanizëm i sigurtë ligjorë, do të ofronte mundësinë që të kishte më shumë shërbime.


[38]Këto te dhëna janë siguruar nga Zyra për Qeverisje të Mirë-Zyra e Kryeministrit në Kosovë.

Tabela 2: Numri i përfituesve të shërbimeve në gjuhën e shenjave në 7 regjione të Kosovës



Po ashtu në f.27 të studimit në fjalë, janë paraparë edhe numri i përfituesve në të gjitha legjionet e Kosovës. Natyrisht, fakti që do të këtë një ligj për Gjuhën e Shenjave, do të rritet edhe mundësia që të ketë më shumë përfitues, për shkak të obligueshmërisë dhe sigurisë më të madhe juridike.

Seancat interpretuese



[39]

Tabela 3 paraqet ndarjen e shërbimeve në bazë të suazave të ndryshme

Tabela 3, bazuar në studimin e lartpërmendur f.27,po ashtu paraqet prezencën e interpretove gjuhësor të gjuhës së shenjave në institucionet përkatëse publike. Megjithatë, një ligj i ri do të ndikonte në lehtësimin dhe shtimin e interpretëve gjuhësor dhe respektivisht përmirësimin e gjendjes dhe rritjen e numrit të interpretëve.

Në përgjithësi, në kudër të këtij seksioni, mund të jepet përfundimi se opsioni 3 i hartimit të ligjit për Gjuhën e Shenjave përbën një opsion që ka ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e statusit dhe gjendjes së personave të shurdhër në Republikën e Kosovës.

Kapitulli 4.1: Sfidat me mbledhjen e të dhënave

Mbledhja e të dhënave ka qenë një proces kompleks në vetvete, me qëllim të arsyetimit më të mirë të çështjes së opsionit më të mirë, respektivisht opsionit të hartimit të Ligjit për Gjuhën e Shenjave. Të dhënat përsa i përket hartimit të këtij koncept dokumenti janë mbledhur nga burimet vijuese: takimet me palët e interesit; takimet me shoqatën e të shurdhërve të Kosovës; takimet me institucionet përkatëse; takimet me organizata të cilat mbështesin personat e shurdhër; raporte dhe të dhëna në raporte të ndryshme vendore; raporte dhe të dhëna nga dokumentet ndërkombëtare që trajtojmë praktikat krahasimore etj.

Po ashtu pjesë e rëndësishme e përpunimit të të dhënave ka qenë edhe takimi për hartimin e konceptdokumentit me datë 13.09.2024, në të cilin takim SHKSH dhe interpretët kanë paraqitur të dhëna konkrete të cilat janë prezantuar në këtë koncept dokument.

[39]Këto te dhëna janë siguruar nga Zyra për Qeverisje të Mirë-Zyra e Kryeministrit në Kosovë.

Sfidat në mbledhjen e të dhënave kanë qenë relative për shkak të qasjes konstruktive të SHKSH dhe të dhënave që SHKSH posedon për personat e shurdhër në Kosovë dhe qasjen e tyre.

Kapitulli 5: Komunikimi dhe konsultimi

Figura 7: Përmbledhje e aktiviteteve të komunikimit dhe konsultimit të kryera për një koncept dokument

Procesi i konsultimit synon:						
Qëllimi kryesor	Grupi i synuar	Aktiviteti	Komunikimi/njoftimi	Afati indikativ	Buxheti i nevojshëm	Personi përgjegjës
Takimi i hapur për të gjitha palët e interesuara	Të gjitha palët e interesuara	Takim publik	ZQM	Dhjetor Janar 2025	N/A	
Takimi me shoqatën Kosovare të të Shurdhërve	Anëtarët e shoqatës	Tryeze publike	ZQM	Janar Shkurt 2025	N/A	
Konsultimi paraprak	Të gjitha palët e interesuara të dërgojnë komente	Ndjekja e formës që aplikohet për konsultimin paraprak.	ZQM	Mars 2025	N/A	
Konsultimi publik me shkrim	Të gjitha palët e interesuara	Publikimi i konsultimit në portalin për konsultim publik	ZQM	Prill 2025	N/A	

Përgjatë procesit të konsultimeve janë shqyrtuar të gjitha opsionet e paraqitura si dhe është adresuar aspekti i përkufizimit të problemit. Procesi i hartimit të koncept dokumentit dhe konsultimit ka shqyrtuar komente të pranuara nga palët e interesit, përfshirë edhe palët e jashtme.

Në përgjithësi, gjatë konsultimeve, ka qenë evidente që mungesa e ligjit për gjuhën e shenjave paraqet pengesa konkrete për personat e shurdhër që kanë të bëjnë me:

- Qasjen e kufizuar në jetën sociale dhe izolimi;
- Qasjen e kufizuar në arsim dhe edukim;
- Qasjen e kufizuar në shërbime dhe në jetën e përditshme;
- Mungesën e mekanizmave efikas në ofrimin e shërbimeve.

Kapitulli 6: Krahasimi i opsioneve

Janë dhënë tri opsione të cilat janë trajtuar edhe më sipër dhe këto opsione janë si në vijim:

- Opsioni 1, pa asnjë ndryshim
- Opsioni 2. i përmirësimit të zbatimit dhe ekzekutimit
- Opsioni 3, i hartimit të një Ligji për Gjuhën e Shenjave

Nuk ka dilemë që bazuar edhe në sqarimet e mësipërme, opsioni i tretë është opsioni i favorizuar në aspektin e gjetjes së zgjidhjes, përkatësisht opsioni i vetëm i cili e ndryshon gjendjen juridike por edhe faktike.

Opsioni i parë ka të bëjë me ruajte e gjendjes faktike dhe juridike ashtu siç është, me bazën ligjore aktuale. Ky opsion nënkupton që të drejtat e personave të shurdhër dhe gjuha e shenjave të trajtohet pa asnjë ndryshim, respektivisht vetëm bazuar në bazë ligjore të brishtë dhe jo shumë të qartë, e cila do të mundësonte një trajtim më ndryshe të personave të shurdhër, si dhe një qasje të barabartë të tyre në shoqëri.

Ky opsion ndër të tjera: Nuk do të ndryshonte gjendjen ekzistuese; nuk do të realizonte të drejtat e personave të shurdhër në mënyrë efikase; nuk do të mundësonte qasje efikase të personave të shurdhër në arsim dhe qasje në shërbime të tjera publike. Mbi të gjitha do të vazhdonin problemet e njëjta, të peronave të shurdhër, të cilët nuk kanë një status të qartë as ligjor, por as një strukturë të mjaftueshme nënligjore për realizimin e të drejtave të tyre. Siç u theksua më sipër, praktika ka treguar që në Kosovë, personat e shurdhër shpesh herë në mungesë të gjuhës së shenjave, përmes kësaj baze nënligjore janë diskriminuar dhe nuk kanë pasur qasje në shërbime dhe jetë publike përgjithësisht.

Opsioni i dytë është opsioni sipas të cilit, baza ligjore do të ishte e njëjtë vetëm do të përmirësohej zbatimi dhe ekzekutimi i politikave praktikisht të njëjta. Kjo nënkupton që supozohet që institucionet përkatëse përgjegjëse do të përmirësojnë politikën e zbatimit dhe ekzekutimit. Megjithatë ky opsion shtron shumë dilema, e mbi të gjitha kur kihet parasysh që baza juridike është krejtësisht e njëjtë. Në çdo aspekt, opsioni që të kemi një bazë ligjore të njëjtë dhe të pritet që do të ketë një zbatim në efikas, të politikave dhe bazës ligjore ekzistuese, duket praktikisht shumë e vështirë. Këtë opsion e bën të vështirë edhe fakti se institucionet përkatëse që kanë zbatuar kornizën juridike në lidhje me gjuhën e shenjave, do ta kenë praktikisht të vështirë ta zbatojnë masa të reja afirmative të mundshme lidhur me personat e shurdhër si dhe gjuhën e shenjave. Andaj, në përgjithësi, në krahasim të opsioneve, gjithnjë opsioni 1 dhe opsioni 2 i promovuar, bashkëjetojnë me njëra tjetrën dhe janë të varura nga njëra tjetra. E përbashkëta e këtyre dy opsioneve është fakti se ato do të operojnë në një bazë të njëjtë juridike.

Në anën tjetër, opsioni i tretë është një opsion krejt i kundërt me dy të parat dhe ka të bëjë me hartimin dhe miratimin e një ligji të veçantë për gjuhën e shenjave. Kjo praktikë është e përhapur gjerësisht dhe se shumë shtete kanë praktikuar të pasurit një ligj të veçantë për gjuhën e shenjave. Ky opsion si njëri ndër kryesorët i promovuar, zgjidh problemin e personave të shurdhër si dhe rregullon opozitën e tyre shoqërore si dhe qasjen e tyre në institucione dhe në jetën publike.

Siç është elaboruar edhe më sipër, përparësitë e këtij opsioni, në raport me dy të parat janë:

1. Baza më e fortë juridike për personat e shurdhër;
2. Obligueshmëria dhe rregullimi i statusit të personave të shurdhër dhe gjuhës së shenjave;
3. Rregullimi i gjendjes së personave të shurdhër në shoqëri dhe pa diskriminim;

4. Qasja më e lehtë e personave të shurdhër në arsim;
5. Qasja më e lehtë e personave të shurdhër në punësim;
6. Qasja më e lehtë e personave të shurdhër në media;
7. Qasja më e lehtë e personave të shurdhër në shërbime publike;
8. Qasja më e lehtë e personave të shurdhër në shërbime shëndetësore;
9. Krijimi i mekanizmave mbrojtës për personat e shurdhër dhe gjuhën e shenjave;
10. Krijimi i një situate më të sigurtë dhe i sigurisë juridike për personat e shurdhër;
11. Përputhshmëria me direktivat e BE-së, të përmendura më sipër;
12. Qasja në teknologji dhe inovacion;
13. Shërbime të interpretimit në kohë reale;
14. Mekanizmat e monitorimit dhe zbatimit të ligjit;

Arsyetimi i opsionit për Ligjin për Gjuhën e Shenjave në kuptim të krahasimit të opsioneve

Në kuptimin e arsyetimit të përmbajtjes së ligjit për gjuhën e shenjave, do të duhej të përcaktoheshin dispozita konkrete, të cilat e definojnë gjuhën e shenjave, personat që i dedikohen dhe aspektet e tjera operative të mënyrë se si do të përdoret gjuha e shenjave për personat e shurdhër.

Disa çështja që do të adresonte opsioni 3, respektivisht hartimi i Ligjit për Gjuhën e Shenjave, janë:

Njohja e të drejtave gjuhësore dhe statusi ligjor i gjuhës së shenjave

Gjuha e shenjave është një gjuhë e veçantë dhe e plotë me gramatikë dhe sintaksë të vetën. Njohja ligjore është e rëndësishme për të afirmuar të drejtat gjuhësore të përdoruesve të gjuhës së shenjave. Ligji për gjuhën e shenjave do të duhej të përcaktonte njohjen e të drejtave gjuhësore për personat e shurdhër dhe në veçanti do të përcaktonte një status zyrtar publik të gjuhës së shenjave dhe komunitetit që i takon ajo.

E drejta për përdorimin e gjuhës së shenjave

Po ashtu, një çështje e rëndësishme që do të përfshinte ligji për gjuhën e shenjave do është edhe përdorimi i të njëjtës për personat e shurdhër dhe e drejta që këtë gjuhë ta përdorin, në të gjitha institucionet publike, për të marrë shërbimet e nevojshme në mënyrë efikase. Në këtë aspekt, një gjë e tillë mund të bëhet përmes shërbimeve të interpretëve, ku edhe do të krijohej mekanizmi përkatës për licencimin dhe certifikimin e tyre, siç është e paraparë në kuadër të akteve nënligjore aktuale në fuqi në Republikën e Kosovës.

Qasja dhe përfshirja

Ligji për gjuhën e shenjave siguron që shërbimet dhe informacionet themelore janë të arritshme dhe të qasshme për komunitetin e shurdhër, duke promovuar përfshirjen e tyre të plotë në shoqëri. Në këtë aspekt, duhet të rregullohet qasja dhe përfshirja e personave të shurdhër, përmes gjuhës së shenjave.

Edukimi dhe Arsimi

Qasja në arsim të cilësisë në gjuhën e shenjave është themelore për fëmijët e shurdhër për të arritur potencialin e tyre të plotë. Ligji mund të kërkojë sigurimin e udhëzimeve dhe burimeve në gjuhën e shenjave në ambientet arsimore. Andaj, një nen i veçantë në ligj duhet t'i kushtohet aspektit të arsimit dhe krijimit të mekanizmave dhe resurseve që kanë të bëjnë me fushën e arsimit, punonjësit e arsimit, trajnimin e tyre me gjuhën e shenjave, mënyrën e përdorimit të gjuhës së shenjave në shkolla etj.

Është e rëndësishme që në aspektin e gjuhës së shenjave, përmes ligjit të mundësohet edhe akreditimi i programeve përkatëse për çështjen e trajnimit dhe certifikimit të interpretove gjuhësore. Kjo mund të bëhet përmes mekanizmave kompetent siç është autoriteti kombëtar i kualifikimeve apo edhe Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI).

Po ashtu përmes ligjit është e rëndësishme të përcaktohet edhe vendosjes së gjuhës së shenjave në kurrikulë, në mënyrë që aspekti i kurrikular për këtë gjuhë, për komunitetin e të shurdhërve të jetë obligativ dhe të ketë qasje efikase në arsim.

Mundësitë e punësimit dhe aftësimit profesional

Dispozitat ligjore mund të promovojnë mundësi të barabarta të punësimit duke kërkuar nga punëdhënësit që të akomodojnë nevojat e komunikimit të punonjësve të shurdhër përmes përkthyesve të gjuhës së shenjave dhe metoda të tjera. Gjithashtu, kjo komponentë, përsa i takon gjuhës së shenjave do të duhej të rregullonte edhe qasjen në vendin e punës si dhe përdorimin e gjuhës së shenjave, për të pasur një ambient gjerësisht jo diskriminues. Po ashtu, gjuha e shenjave do të duhej që përmes ligjit të forcohej edhe në aspektin e aftësimit profesional.

Mbrojtja nga diskriminimi

Ligji për gjuhën e shenjave duhet të shërbejë si një garancion juridik i veçantë për personat e shurdhër, me qëllim të mbrojtjes së komunitetit të të shurdhëve nga diskriminimi, në arsim, punësim dhe shërbime të tjera publike në përgjithësi.

Qasja në shërbime shëndetësore, sociale dhe shërbime të tjera

Individët e shurdhër shpesh ballafaqohen me barrierat në qasjen në shërbime shëndetësore për shkak të sfidave të komunikimit. Ligji mund të kërkojë disponueshmërinë e shërbimeve interpretuese të gjuhës së shenjave në strukturat shëndetësore. Kjo do ti mundësonte qasjen më të lehtë të personave të shurdhër, përsa i takon nevojës së tyre për përdorimin e gjuhës së shenjave.

Është e arsyeshme që bazuar edhe në praktikat ndërkombëtare (shih përkufizimi i problemit), të përcaktohet një mekanizëm i vënies në dispozicion të interpretove gjuhësor, në mënyrë që komunikimi i të shurdhërve të mos jetë i pamundur, në mungesë të interpretuesve. Ligji për gjuhën e shenjave do ti mundësonte personave të shurdhër një qasje më të lehtë në shërbime shëndetësore dhe sociale.

Trashëgimia dhe identiteti i të shurdhërve si vlerë dhe dokumentimi i gjuhës së shenjave

Gjuha e shenjave është pjesë e pandashme e kulturës së personave të shurdhër. Njohja ligjore ndihmon në ruajtjen dhe promovimin e kësaj trashëgimie kulturore. Do të duhej një nen i cili përcakton çështjen trashëgimisë kulturore. Po ashtu, në këtë nen do të duhej të definohej edhe mbështetja e organizatave përkatëse për mbrojtjen e të drejtave të personave të shurdhër. Në kuadër të kësaj kategorie dhe me qëllim të njohjes së trashëgimisë së të shurdhërve në ligj duhet të përcaktohet lejueshmëria e fushatave publike dhe evokimeve të caktuara për të promovuar gjuhën e shenjave dhe për të mundësuar që komuniteti i të shurdhërve të ndihen të barabartë në çdo aspekt të trajtimit të tyre. Një çështje e rëndësishme që do të arrihet me këtë opsion është edhe dokumentimi i gjuhës së shenjave, që do të mundësohej, përmes një ligji.

Qasja e të shurdhërve në publik dhe raporti me median

Në kuptimin e qasjes së barabartë në informacione për të shurdhrit, është me dhe brenda praktikave të mira që në ligj të përcaktohet se transmetuesit publik, duhet të vënë në dispozicion interpreto, në edicionet kryesore dhe emisionet televizive, në mënyrë që të shurdhrit të mund të kuptojnë. Po ashtu kjo duhet të vlejë edhe për faqet kryesore dhe me interes që janë asete shtetërore, në mënyrë që videot dhe informacionet kryesore të shfaqen në gjuhën e shenjave.

Sigurimi i interpretimit profesional të gjuhës së shenjave

Një ligji i ri për gjuhën e shenjave do të mundësonte krijimin e një mekanizmi obligues për caktimin e interpretove profesional për gjuhën e shenjave. Po ashtu, do të rritej numri i interpretëve si dhe shërbimi i interpretimit do të bëhej më efikas. Kjo do të mundësonte qasjen më të lehtë në shërbime për personat e shurdhër.

Avokimi dhe sensibilizimi për gjuhën e shenjave

Avokimi dhe sensibilizimi janë një çështje me rëndësi që do të adresonte opsioni i tretë. Përmes procesit të avokimit dhe të sensibilizimit do të ndihmohej komuniteti i të shurdhërve, në mënyrë që atë të realizojnë shërbimet dhe të drejtat e tyre, respektivisht të mos ekspozohen në situata të diskriminimit.

Krijimi i mekanizmave për zbatim

Ligji për gjuhën e shenjave duhet të përcaktojë që të ketë një mekanizëm shtetëror, zyrë apo zyrtarë përkatës në kuadër të institucioneve që trajtojnë aspektin e gjuhës së shenjave, zbatimin e ligjit, monitorimin e zbatimit të ligjit si dhe mbajtjen e evidencave përkatëse që tregon dhe flet për zbatimin e gjuhës ligjit për gjuhën e shenjave.

Si përfundim, disa cështje kryesore që do të adresonte ligji, respektivisht opsioni i tretë janë: Gjuha e shenjave dhe statusi i saj; Gjuha e shenjave në edukim dhe arsim; Gjuha e shenjave në punësim; Gjuha e shenjave në ofrimin e shërbimeve shëndetësore dhe sociale; Gjuha e shenjave në media dhe qasja në informim; Përdorimi i gjuhës së shenjave; Programet dhe evokimi për gjuhën e shenjave; Interpretët e gjuhës së shenjave; Mbrojtja nga diskriminimi; Ankesat; Mekanizmat institucional pr zbatimin e ligjit për gjuhën e shenjave; Nxjerrja e akteve nënligjore; Dispozitat kalimtare; Dispozitat përfundimtare.

Kapitulli 6.1: Planet e zbatimit për opsionet e ndryshme

Siç është theksuar, opsioni 1 dhe 2 janë opsione të përbashkëta dhe janë të lidhura me njëra tjetrën, për shkak se bazohen në të njëjtën bazë ligjore. Në kontekst të kësaj, opsioni 2 është i lidhur me opsionin 1 dhe anasjelltas, për shkak se opsioni 1 promovon aspektin e njëjtë të legjislacionit dhe pa ndryshime, kurse opsioni 2 nënkupton zbatimin dhe ndryshimin e politikave ekzekutive, por brenda bazës së njëjtë ligjore, përfshirë edhe përmirësimin e politikave ekzekutive. Opsioni 2 në këtë aspekt, kërkon një aktivitet më të shtuar dhe dinamik të institu cioneve, në kuptimin e zbatimit të rregullativës aktuale, për të përmirësuar gjuhën e shenjave dhe pozitën e personave të shurdhër në shoqëri.

Figura 8: Plani i zbatimit për Opsionin 1

Qëllimi i Politikës	**Zbatimi i rregullatives dhe gjendjes aktuale për gjuhën e shenjave**							Shifra e kostos së pritur
Objektivi Strategjik								
	Produktet, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës							
Krijimi i mekanizmave për monitorimin e politikave për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar	Produkti 1.1 Kuadri ekzistues ligjor dhe administrativ							
		Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	0
	Aktiviteti 1.1 1.1.Analizimi i zbatimit aktual të Rregullores (QRK) Nr. 15/2014 dhe identifikimi i boshllëqeve ekzistuese.		/	/	/	/	ZQM/ZKM	50000
	Aktiviteti 1.2. 1.2.1.Konsultime me Shoqatën e të Shurdhërve dhe palët e interesuara për nevojat ekzistuese	Viti 1	/	/	/	/	ZQM/ZKM	940
	Aktiviteti 1.2.2.Përgati		/	/	/	/	ZQM/ZKM	10000

		tja e raportit me rekomandime administrative për përmirësim të zbatimit							
		Aktiviteti 1.3.1. 4.Ngritja e vetëdijes së institucione ve publike për zbatimin e rregullores ekzistuese			/	/	/	ZQM/ZKM dhe SHKSH	50000
									119400

Figura 9: Plani i zbatimit për Opsionin 2

Qëllimi i Politikës	**Përmirësimi i zbatimit të shërbimeve për gjuhën e shenjave**							Shifra e kostos së pritur
Objektivi Strategjik								
	Produktet, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës							
Përmirësimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse sociale për personat me aftësi të kufizuar	Produkti 1.1 Kuadri institucional dhe nënligjor i përmirësuar							
			Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	
		Aktiviteti 1.1 1.Krijimi i mekanizmit koordinues ndërinstitucional për çështjet e		/	/	/	/	ZQM/ZKM	10000€

		gjuhës së shenjave							
		Aktiviteti 1.2. 2.Hartimi i standardeve profesionale për certifikimin e interpretive	Viti 1	/	/	/	/	ZQM/ZKM	10000€
		Aktiviteti 1.3. Zgjerimi i ofrimit të shërbimeve në gjuhën e shenjave edhe në sektorin privat		/	/	/	/	ZQM/ZKM	70000€
		Aktiviteti 1.4 Zhvillimi i fushatave të vetëdijesimit publik për përdorimin e gjuhës së shenjave			/	/	/	ZQM/ZKM dhe SHKSH	29400€
									119400€

Në anën tjetër, siç është theksuar në kuadër të këtij koncept dokumenti, opsioni i tretë prodhon një situatë tërësisht tjetër, juridike dhe faktike. Në këtë aspekt, ky opsion nënkupton ndërtimin e një realiteti krejtësisht të ri juridik, ku përmes hartimit të Ligjit për Gjuhën e Shenjave, do të mundësohet njohja e gjuhës së shenjave dhe rregullimi i pozicionit të personave të shurdhër në shoqëri. Ligji do të mundësojë hapjen e rrugëve dhe mundësive që pozita e personave të shurdhër të rregullohet, gjuha e shenjave të njihet dhe të rregullohet, të rregullohet mekanizmi i zbatimit të gjuhës së shenjave, të eliminohet situatat diskriminuese ndaj personave të shurdhër, si pasojë e mungesës së sigurisë juridike përkitazi me gjuhën e shenjave etj.

Figura 9: Plani i zbatimit për Opsionin 3

Qëllimi i Politikës	**Hartimi i kornizës së re ligjore për gjuhën e shenjave**							Shifra e kostos së pritur
Objektivi Strategjik	Objektivi strategjik 1. Përmirësimi i cilësisë në shërbime sociale për persona me aftësi të kufizuar							
	Produktet, aktivitetet, viti dhe organizata/departamenti përgjegjës							
Objektivi specifik I.1 Përmirësimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse sociale për personat me aftësi të kufizuar	Produkti 1.1 Ligji për Gjuhën e Shenjave i hartuar dhe miratuar							
			Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Institucioni /departamenti përgjegjës	0
		Aktiviteti 1.1.1 Miratimi i koncept-dokumentit nga Qeveria	/	/	/	/	/	Qeveria	20000€
		Aktiviteti 1.1.2 Themelimi i grupit punues ndërinstitucional (ZKM, MASHTI, MSH, MF, MD, Shoqata e të Shurdhërve) .	Hartimi i ligjit të ri/miratimi	/	/	/	/	ZKM/ZQM	20000€
		Aktiviteti 1.1.3 Hartimi dhe miratimi i draft-ligjit në përputhje me Konventën e OKB-së dhe standardet evropiane.	Validimi i ligjit të ri me palët e interesit	/	/	/	/	Qeveria	10000 €
		Aktiviteti 1.1.4	/	/	/	/		Qeveria	5000 €

		Dërgimi i projektligjit në Kuvend për shqyrtim dhe miratim.							
	Produkti 1.2 Kuadri nënligjr dhe institucional i funksionalizuar								
			Viti 1	Viti 2	/	/	/	Institucioni /departamenti përgjegjës ZQM	0
		Aktiviteti 1.2.1 Hartimi i udhëzimeve administrative, rregulloreve dhe standardeve për zbatim			/	/	/	ZQM	30000€
		Aktiviteti 1.2.2 Krijimi i mekanizmit institucional për koordinim dhe monitorim të ligjit						ZQM	20000€
		Aktiviteti 1.2.3 Caktimi i njësive përgjegjëse						ZQM, SHKSH, MSH, MASHTI, MMPHI	30000€

		në ministritë përkatëse							
Objektivi specifik II.2: Ngritja e kapaciteteve të stafit mbështetës për personat me aftësi të kufizuar si dhe personave me aftësi te kufzuar	Produkti 2.1 Kapacitete profesionale të ngritura dhe shërbime të qasshme	Aktiviteti 2.1.1 Trajnimi dhe certifikimi i interpretëve të gjuhës së shenjave	Lista e trajnimeve	/	/	/	/	ZQM	40000€
		Aktiviteti 2.1.2 Zhvillimi i moduleve të mësimit dhe trajnimeve për zyrtarët publikë						ZQM	40000€
		Aktiviteti 2.1.3 Zbatimi i programeve për përfshirjen e gjuhës së shenjave në arsim, media dhe administratë publike.						ZQM	10000€
	Produkti 2.2 Zbatim efektiv dhe monitorim	Aktiviteti 2.2.1 Mbledhja e të dhënave dhe përcaktimi i	Dizajnimi dhe hapja e konkursit publik për rekrutim	/	/	/	/	ZQM	10000€

	i qëndrueshëm i ligjit	indikatorëve të performances	të nëpunësve të ri, interpetëve etj						
		Aktiviteti 2.2.2 Përgatitja e raporteve vjetore të monitorimit dhe raportimi në Qeveri							5000€
		Aktiviteti 2.2.3 Zhvillimi i fushatave të vetëdijesimit për të drejtat e personave të shurdhër							29400€
									269400€

Kapitulli 6.2: Tabela e krahasimit me të tre opsionet

Krahasimi i opsioneve vendos qartësisht përparësitë dhe mangësitë që i kanë të njëjtat, në krahasim. Këtu paraqiten edhe ndikimet e opsioneve në aspektin e asaj se çfarë ofrojnë.

Figura 10: Krahasimi i opsioneve

Metoda e krahasimit:

Ndikimet relevante pozitive	Opsioni 1: Asnjë ndryshim			Opsioni 2: Përmirësimi i zbatimit dhe ekzekutimit			Opsioni 3:		
	Nuk ka ndikim pozitiv substancial			Ndikimi pozitiv është i kufizuar			Përmirësohet dukshëm statusi i gjuhës së shenjave dhe personave të shurdhër		
	Nuk përmirësohet gjendja e e personave të shurdhër			Dinamizohet puna e institucioneve në kuptim të ekzekutitimit			Personave të shurdhër i mundësohet qasje në jetën publike dhe në marrjen e shërbimeve pa kufizime dhe në mënyrë efikase		
	Gjendja juridike mbetet e njëjtë			Mund të forcohen pjeërisht mekanizmat e prezencës së gjuhës së shenjave në institucione			Krijohen mekanizmat e ri për për gjuhën e shenjave		
							Krijohen mekanizma institucional të cilat ndikojnë në përmirësimin e pozitë së personave të shurdhër dhe statusit të gjuhës së shenjave në Republikën e Kosovës		
Ndikimet relevante negative									
	Moszgjidhja e problemeve ekzistuese si ndikim negativ			Zgjdihja e pjesërishme e problemeve për gjuhën e shenjave			Nuk ka ndonjë ndikim negativ të parashikuar		
Kostot relevante									
	Nuk ka asnjë kosto shtesë			Ka zvogëlim minimal të kostove aktuale			Ka kosto shtesë		
Vlerësimi i ndikimit të pritshëm buxhetor	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 1	Viti 2	Viti 3
	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
Përfundimi	119,400.00€			109,400.00 euro			269,400.00 euro		

Kapitulli 7: Konkluzionet dhe hapat e ardhshëm

Problemi kryesor i cili është paraqitur tek adresimi i problemit është pozita e personave të shurdhër në shoqërinë kosovare dhe mungesa e gjuhës së shenjave. Në mungesë të një baze ligjore të qëndrueshme, nuk ka asnjë dilemë që opsioni më i favorizuar dhe më i ndeshëm, që e zgjidhë problemin e gjuhës së shenjave eshtë hartimi i Ligjit për Gjuhën e Shenjave. Ky ligj, në momentin e miratimit do të ofronte një gamë të përparësive, në aspektin e zgjidhjes së problemit për personat e shurdhër dhe atë si në vijim:

1. Rregullimin e statusit të personave të shurdhër;
2. Njohjen e statusit të gjuhës së shenjave;
3. Ofrimin e Sigurisë juridike për personat e shurdhër;
4. Krijimin e mundësive të qasjes së peronave të shurdhër në punësim;
5. Krijimit të mundësive të qasjes së peronave të shurdhër në arsim;
6. Krijimin e mundësive të marrjes së shërbimeve dhe qasjes së personave të shurdhër në jetën publike;
7. Krijimin e mekanizmave teknik për zbatimin e gjuhës së shenjave dhe krijimin e mekanizmave përkatës për zbatim;
8. Krijimin dhe avancimin e mekanizmave dhe infrastrukturës teknike për zbatimin e ligjit për gjuhën e shenjave.
9. Krijimi i mundësive për rritjen e numrit të interpetëve dhe ofrimit të shërbimeve të interpretimit në kohë reale;
10. Krijimi i mundësive për njohjen e gjuhës së shenjave si vlerë.

Figura 11: Plani i zbatimit të opsionit të preferuar

Konsultimet publike për koncept dokumentin – 11-29/08/2025
Miratimi i koncept dokumentit në Qeveri - xx/xx/2025
Themelimi i grupit punues për hartimin e ligjit të ri - xx/xx/2025 ose 2026
Hartimi i ligjit të ri për Gjuhën e Shenjave në xx/xx/2025
Miratimi i projektligjit të ri për Gjuhën e Shenjave në Qeveri - xx/xx/2025 ose 2026
Miratimi i projektligjit të ri për Gjuhën e Shenjave në Kuvend xx/xx/2025 0se 2026
Krijimi i kushteve më të favorshme për gjuhën e shenjave në arsim
Krijimi i mekanizmave të ri që ndihmojnë ofrimin e gjuhës së shenjave
Ndalimi i rasteve të diskriminimit për personat e shurdhër
Përmirësimi i qasjes teknologjike në ofrimin e gjuhës së shenjave
Rritja e numrit të interpretëve për gjuhën e shenjave

Kapitulli 7.1: Dispozitat për monitorimin dhe vlerësimin

Zbatimi i koncept dokumentit do të vlerësohet sa i përket arritjes së objektivave përmes monitorimit të saj nga Zyra për Qeverisje të Mirë. Për të njëjtën do t'i raportohet në baza të rregullta edhe në konsultim me akterët, palët e interesit etj

Siç është theksuar edhe më sipër, koncept dokumenti vetë është hartuar mbi në bazën e konsultimit me SHKSH dhe akterët e tjerë kyç, respektivisht institucionet kompetente.

Koncept dokumenti ka kaluar dhe është monitoruar në fazën e konsultimit paraprak dhe konsultimeve publike. Konsultimet paraprake kanë prodhuar komentet përkatëse nga institucionet kurse përgjatë konsultimeve publike janë marrë komente nga OSCE dhe nga UNMIK. Faza e konsultimeve publike ka qenë 15 ditë pune, respektivisht nga data, 11.08.2025-29.08.2025.

Koncept dokumenti do të vazhdojë që të monitorohet edhe më tutje nga ZQM në kuptimin e zbatimit, përgjatë hartimit të ligjit të ri për gjuhën e shenjave, si opsion i propozuar në këtë koncept.

Shtojca 1: Forma e vlerësimit për ndikimin ekonomik

Kategoria e ndikimeve ekonomike	**Ndikimi kryesor**	**A pritet të ndodhë ky ndikim?**		**Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur**	**Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit**	**Niveli i preferuar i analizës**
		Po	**Jo**	**I lartë/i ulët**	**I lartë/i ulët**	
Vendet e punës[40]	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?	x		N/A	N/A	N/A
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		x			
	A do të ndikojë në nivelin e pagesës?	x		N/A	N/A	N/A
	A do të ndikojë në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?	x		N/A	N/A	N/A
Bërja e biznesit	A do të ndikojë në qasjen në financa për biznes?	x		N/A	N/A	N/A
	A do të largohen nga tregu produkte të caktuara?		x			
	A do të lejohen në treg produkte të caktuara?					
	A do të detyrohen bizneset të mbyllen?		x			
	A do të krijohen biznese të reja?					
Ngarkesa administrative	A do të detyrohen bizneset t'i përmbushin detyrimet e dhënies së informatave të reja?		x			
	A janë thjeshtuar detyrimet e dhënies së informatave për bizneset?		x			
Tregtia	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të importit?		x			
	A pritet të ndryshojnë flukset aktuale të eksportit?		x			

[40] Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime shoqërore.

Transporti	A do të ketë efekt në mënyrën e transportit të pasagjerëve dhe/ose mallrave?		x			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në kohën e nevojshme për të transportuar pasagjerë dhe/ose mallra?		x			
Investimet	A pritet që kompanitë të investojnë në veprimtari të reja?		x			
	A pritet që kompanitë t'i anulojnë ose shtyjnë për më vonë investimet?		x			
	A do të rriten investimet nga diaspora?		x			
	A do të zvogëlohen investimet nga diaspora?		x			
	A do të rriten investimet e huaja direkte?		x			
	A do të zvogëlohen investimet e huaja direkte?		x			
Konkurrueshmëria	A do të rritet çmimi i biznesit të produkteve, siç është energjia elektrike?		x			
	A do të ulet çmimi i inputeve të bizneseve, siç është energjia elektrike?		x			
	A ka gjasa që të promovohen inovacioni dhe hulumtimi?		x			
	A ka gjasa që inovacioni dhe hulumtimi të pengohen?		x			
Ndikimi në NVM	A janë kompanitë e prekura kryesisht NVM?		x			
Çmimet dhe konkurrenca	A do të rritet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		x			
	A do të zvogëlohet numri i mallrave dhe shërbimeve në dispozicion për biznesin apo konsumatorët?		x			

	A do të rriten çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		x			
	A do të ulen çmimet e mallrave dhe shërbimeve ekzistuese?		x			
Ndikimet ekonomike rajonale	A do të ndikohet ndonjë sektor i veçantë i biznesit?		x			
	A është ky sektor i koncentruar në një rajon të caktuar?		x			
Zhvillimi i përgjithshëm ekonomik	A do të ndikohet rritja e ardhshme ekonomike?		x			
	A mund të ketë ndonjë efekt në normën e inflacionit?		x			

Shtojca 2: Forma e vlerësimit për ndikimet shoqërore

Kategoria e ndikimeve shoqërore	Ndikimi kryesor	A pritet të ndodhë ky ndikim?		Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur	Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit	Niveli i preferuar i analizës
		Po	Jo	I lartë/i ulët	I lartë/i ulët	
Vendet e punës [41]	A do të rritet numri aktual i vendeve të punës?	x		N/A	N/A	N/A
	A do të zvogëlohet numri aktual i vendeve të punës?		x			
	A ndikohen vendet e punës në një sektor të caktuar të biznesit?	x		N/A	N/A	N/A
	A do të ketë ndonjë ndikim në nivelin e pagesës?	x		N/A	N/A	N/A
	A do të ketë ndikim në lehtësimin e gjetjes së një vendi të punës?	x		N/A	N/A	N/A
Ndikimet shoqërore rajonale	A janë ndikimet shoqërore të përqendruara në një rajon apo qytete të veçanta?	x		N/A	N/A	N/A
Kushtet e punës	A ndikohen të drejtat e punëtorëve?	x				
	A parashihen apo shfuqizohen standardet për punën në kushte të rrezikshme?		x			
	A do të ketë ndikim mbi mënyrën e zhvillimit të dialogut social ndërmjet punonjësve dhe punëdhënësve?	x		N/A	N/A	N/A
Përfshirja sociale	A do të ketë ndikim mbi varfërinë?		X			
	A ndikohet qasja në skemat e mbrojtjes sociale?		X			

[41] Kur ndikon në vendet e punës, gjithashtu do të ketë edhe ndikime ekonomike.

	A do të ndryshojë çmimi i mallrave dhe shërbimeve themelore?		X			
	A do të ketë ndikim në financimin apo organizimin e skemave të mbrojtjes sociale?		X			
Arsimi	A do të ketë ndikim në arsimin fillor?	X		N/A	N/A	N/A
	A do të ketë ndikim në arsimin e mesëm?	X		N/A	N/A	N/A
	A do të ketë ndikim në arsimin e lartë?	X		N/A	N/A	N/A
	A do të ketë ndikim në aftësimin profesional?					
	A do të ketë ndikim në arsimimin e punëtorëve dhe të mësuarit gjatë gjithë jetës?	X		N/A	N/A	N/A
	A do të ketë ndikim në organizimin apo strukturën e sistemit arsimor?	X		N/A	N/A	N/A
	A do të ketë ndikim në lirinë akademike dhe vetëqeverisjen?		X			
Kultura	A ndikon opsioni në diversitetin kulturor?	X		N/A	N/A	N/A
	A ndikon opsioni në financimin e organizatave kulturore?					
	A ndikon opsioni në mundësitë për personat që të përfitojnë nga aktivitetet kulturore ose të marrin pjesë në to?	X		N/A	N/A	N/A
	A ndikon opsioni në ruajtjen e trashëgimisë kulturore?	X		N/A	N/A	N/A
Qeverisja	A ndikon opsioni në aftësitë e qytetarëve të marrin pjesë në procesin demokratik?	X		N/A	N/A	N/A
	A trajtohet çdo person në mënyrë të barabartë?	X		N/A	N/A	N/A
	A do të informohet më mirë publiku në lidhje me çështje të caktuara?	X		N/A	N/A	N/A
	A ndikon opsioni në mënyrën se si funksionojnë partitë politike?		X			

	A do të ketë ndonjë ndikim në shoqërinë civile?		X			
Shëndeti dhe siguria publike[42]	A do të ketë ndonjë ndikim në jetën e njerëzve, siç është jetëgjatësia apo shkalla e vdekshmërisë?		X			
	A do të ketë ndikim në cilësinë e ushqimit?		X			
	A do të rritet apo zvogëlohet rreziku shëndetësor për shkak të substancave të dëmshme?		X			
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në nivelet e zhurmës apo cilësinë e ajrit, ujit dhe/ose tokës?		X			
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në përdorimin e energjisë?		X			
	A do të ketë efekte shëndetësore për shkak të ndryshimeve në deponimin e mbeturinave?		X			
	A do të ketë ndikim në mënyrën e jetesës së njerëzve, siç janë nivelet e interesimit për sport, ndryshimet në ushqyeshmëri, ose ndryshimet në përdorimin e duhanit ose alkoolit?		X			
	A ka grupe të veçanta që përballen me rreziqe shumë më të larta se të tjerat (të përcaktuar sipas faktorëve, të tillë si mosha, gjinia, aftësia e kufizuar, grup shoqëror apo rajoni)?	X		N/A	N/A	N/A
Krimi dhe siguria	A ndikohen gjasat që të kapen kriminelët?		X			
	A ndikohet fitimi i mundshëm nga krimi?		X			
	A ndikon në nivelet e korrupsionit?		X			
	A ndikohet kapaciteti i zbatimit të ligjit?					

[42] Kur ka ndikim në shëndet publik dhe siguri, atëherë rregullisht ka ndikime mjedisore.

	A ka ndonjë efekt në të drejtat dhe sigurinë e viktimave të krimit?		X			

Shtojca 3: Forma e vlerësimit për ndikimet mjedisore

Kategoria e ndikimeve mjedisore	**Ndikimi kryesor**	**A pritet të ndodhë ky ndikim?**		**Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur**	**Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit**	**Niveli i preferuar i analizës**
		Po	**Jo**	**I lartë/i ulët**	**I lartë/i ulët**	
Klima dhe mjedisi i qëndrueshëm	A do të ketë ndikim në emetimin e gazrave serë (dioksid karboni, metani etj.)?		X			
	A do të ndikohet konsumi i karburanteve?		X			
	A do të ndryshojë shumëllojshmëria e burimeve që përdoren për prodhimin e energjisë?		X			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në çmim për produktet miqësore ndaj mjedisit?		X			
	A do të bëhen më pak ndotëse disa aktivitete të caktuara?		X			
Cilësia e ajrit	A do të ketë ndikim në emetimin e ndotësve të ajrit?		X			
Cilësia e ujit	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave të ëmbla?		X			
	A ndikon opsioni në cilësinë e ujërave nëntokësore?		X			
	A ndikon opsioni në burimet e ujit të pijshëm?		X			
Cilësia e tokës dhe shfrytëzimi i tokës	A do të ketë ndikim në cilësinë e tokës (në lidhje me acidifikimin, ndotjen, përdorimin e pesticideve apo herbicideve)?		X			
	A do të ketë ndikim në erozionin e tokës?		X			
	A do të humbet tokë (përmes ndërtimit, etj.)?		X			

	A do të fitohet tokë (përmes dekontaminimit, etj.)?		X			
	A do të ketë ndonjë ndryshim në shfrytëzimin e tokës (p.sh. nga shfrytëzimi pyjor në shfrytëzim bujqësor apo urban)?		X			
Mbeturinat dhe riciklimi	A do të ndryshojë sasia e mbeturinave të krijuara?		X			
	A do të ndryshojnë mënyrat në të cilat trajtohen mbeturinat?		X			
	A do të ketë ndikim në mundësitë për riciklimin e mbeturinave?		X			
Përdorimi i burimeve	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve të ripërtëritshme (rezervave të peshkut, hidrocentraleve, energjisë diellore etj.)?		X			
	A ndikon opsioni në përdorimin e burimeve, të cilat nuk janë të ripërtëritshme (ujërat nëntokësore, mineralet, qymyri etj.)?		X			
Shkalla e rreziqeve mjedisore	A do të ketë ndonjë efekt në gjasat për rreziqe, të tilla, si zjarret, shpërthimet apo aksidentet?		X			
	A do të ndikojë në gatishmërinë në rast të fatkeqësive natyrore?		X			
	A ndikohet mbrojtja e shoqërisë nga fatkeqësitë natyrore?		X			
Biodiversiteti, flora dhe fauna	A do të ketë ndikim në speciet e mbrojtura apo të rrezikuara apo në zonat ku ato jetojnë?		X			
	A do të preket madhësia apo lidhjet midis zonave të natyrës?		X			
	A do të ketë ndonjë efekt në numrin e specieve në një zonë të caktuar?		X			

Mirëqenia e kafshëve	A do të ndikohet trajtimi i kafshëve?		X			
	A do të ndikohet shëndeti i kafshëve?		X			
	A do të ndikohet cilësia dhe siguria e ushqimit të kafshëve?		X			

Shtojca 4: Forma e vlerësimit për ndikimin e të drejtave themelore

Kategoria e ndikimit në të drejtat themelore	**Ndikimi kryesor**	**A pritet të ndodhë ky ndikim?**		**Numri i organizatave, kompanive dhe/ose individëve të prekur**	**Përfitimi i pritshëm ose kostoja e ndikimit**	**Niveli i preferuar i analizës**
		Po	**Jo**	**I lartë/i ulët**	**I lartë/i ulët**	
Dinjiteti	A ndikon opsioni në dinjitetin e njerëzve, në të drejtën e tyre për jetë apo në integritetin e një personi?	X		N/A	N/A	N/A
Liria	A ndikon opsioni në të drejtën e lirisë së individëve?	x		N/A	N/A	N/A
	A ndikon opsioni në të drejtën e një personi për privatësi?	x		N/A	N/A	N/A
	A ndikon opsioni në të drejtën për t'u martuar apo krijuar familje?	x		N/A	N/A	N/A
	A ndikon opsioni në mbrojtjen ligjore, ekonomike ose shoqërore të individëve apo familjes?	x		N/A	N/A	N/A
	A ndikon opsioni në lirinë e mendimit, ndërgjegjes apo fesë?	x		N/A	N/A	N/A
	A ndikon opsioni në lirinë e shprehjes?	x		N/A	N/A	N/A
	A ndikon opsioni në lirinë e tubimit ose asociimit?	x		N/A	N/A	N/A
Të dhënat personale	A përfshin opsioni përpunimin e të dhënave personale?	x		N/A	N/A	N/A
	A janë të drejtat e individit për qasje, korrigjim dhe kundërshtim të garantuara?	x		N/A	N/A	N/A
	A është e qartë dhe e mbrojtur mirë mënyra në të cilën përpunohen të dhënat personale?	x		N/A	N/A	N/A
Azili	A ndikon ky opsioni në të drejtën për azil?		x			
	A do të ndikohen të drejtat e pronësisë?	x		N/A	N/A	N/A

Të drejtat pronësore	A ndikon opsioni në lirinë për të bërë biznes?	x		N/A	N/A	N/A
Trajtimi i barabartë [43]	A e mbron opsioni parimin e barazisë para ligjit?	x		N/A	N/A	N/A
	A ka gjasa që grupe të caktuara do të dëmtohen në mënyrë direkte apo indirekte nga diskriminimi (p.sh. ndonjë diskriminim në bazë gjinore, racore, ngjyre, etnie, opinioni politik ose tjetër, moshe ose orientimi seksual)?	x		N/A	N/A	N/A
	A ndikon opsioni në të drejtat e personave me aftësi të kufizuara?	x		N/A	N/A	N/A
Të drejtat e fëmijëve	A ndikon opsioni në të drejtat e fëmijëve?	x		N/A	N/A	N/A
Administrimi i mirë	A do të bëhen procedurat administrative më të komplikuara?		x			
	A ndikohet mënyra në të cilën administrata merr vendime (transparenca, afati procedural, e drejta për qasje në një dosje, etj.)?	x		N/A	N/A	N/A
	Për të drejtën penale dhe ndëshkimet e parashikuara: a ndikohen të drejtat e të padituri?		x			
	A ndikohet qasja në drejtësi?		x			

[43] Barazia gjinore trajtohet në *Vlerësimin e Ndikimit Gjinor*